



MUFTI PËR TË GJITHË

Njëra nga objektivat kryesore të Fesë është ruajtja e saj dhe uniteti mes muslimanëve. Për realizimin e kësaj objekte janë garantuar mekanizma të ndryshëm të cilët edhe pse dallojnë në rëndësi ata e kanë të njëjtin rol.

Nga më të rëndësishmit për realizimin e këtyre objektivave madhore dhe jetike për muslimanët është zgjedhja e udhëheqësit të tyre, i cili krahas të qenit përfaqësues legjitim i muslimanëve, ai njëherazi merr përsipër edhe një nga obligimet më të shenjta.

Ai merr përsipër ruajtjen e fesë dhe përpiket që përmes formave të ndryshme të organizimit të ngritë vetëdijen fetare tek muslimanët dhe të luftojë të gjitha dukuritë e devijimit dhe keqkuptimit të fesë që kanë mundësi të shfaqen tek ata.

Në Republikën e Kosovës, këto ditë u zhvilluan zgjedhjet për muftiun e ri, i cili – me lejen e Zotit – do ta ushtrojë këtë mandat gjatë pesë viteve në vijim.

Nuk do mend se, po u munduam që në bazë të asaj që përmendëm më lartë të tërheqim një paralele prej atje e deri te realiteti i jonë që sot po e jetojmë dhe sfidat me të cilat ballafaqohemi, do të kuptojmë rëndësinë e kësaj ndodhie dhe përgjegjësitë e atij që është ngarkuar me këtë detyrë.

Edhe pse kjo ishte një ndodhi e rëndësishme dhe mbart në vete përgjegjësi të mëdha, megjithatë ajo nuk e pati ndonjë përcjellje të medieeve që vlen të theksohet, madje as sa disa ndodhi që janë me rëndësi më të vogël se kjo.

Sidoqoftë, muslimanët e Kosovës e fituan Muftiun e ri dhe u takon që të shpresojnë për një të ardhme më të mirë, sa i përket Bashkësisë Islame dhe organizimit të jetës fetare në përgjithësi.

Me stabilizimin e situatës dhe hapjen e mundësive të ndryshme për të ardhur deri te informatat në lidhje me fenë, është bërë një rizgjim i pamohueshëm drejt kthimit të njerëzve në fe.

Këtij kthimi i kanë kontribuar shumë anë, nganjëherë ato zyrtare të lidhura drejtpërdrejtë me organizimin e Bashkësisë Islame e nganjëherë ato që kanë mbetur jashtë këtij organizimi, të cilët vazhdimisht e kanë ndier veten pjesë të kësaj përgjegjësie e assesi rival të këtij organi, i cili ka marr mbi vete prezantimin dhe mbrojtjen e interesave të muslimanëve të Kosovës.

Kur e them këtë, kam për qëllim ata të cilët njohën realitetin e këtij vendi dhe në bazë të kësaj njohurie i ofruan njerëzve mësimë përkatëse në lidhje me fenë e tyre, e assesi nuk kam për qëllim ndonjë të paskrupullt i cili e ka humbur orientimin në kohë dhe në vend.

Mendoj se duhet të gjithë ata të cilët i kanë kontribuar kauzës islame dhe vazhdojnë të jenë të tillë, të cilët promovojnë vlerat e një islami mesatar dhe të kapshëm për muslimanët e këtij vendi, në të gjithë këta të llogarit Muftiu i sapozgjedhur dhe që përmes kanaleve të ndryshme të mirëfillta të artikuloj zërin e të gjithë muslimanëve të këtij vendi.

Edhe pse shumë vende në botë kanë pasur probleme me disa kuptime ekstreme të Islamit nga ana e personave të caktuar e të cilat kuptime janë manifestuar edhe përmes formave më agresive, ne këtu në Kosovë, falë Zotit e pastaj atyre që merren me propagandimin e fesë, nuk kemi pasur gjatë këtyre viteve asnjë problem të këtij lloji.

Jam i bindur se Muftiu, në bazë të asaj që e njohim si njeri me përvojë dhe i guximshëm, do të luaj një rol konstruktiv në mbrojtjen e interesave të të gjithë muslimanëve dhe do të punoj për unifikimin dhe kanalizimin e të gjitha forcave që punojnë me përgjegjësi dhe vetëdije për këtë Fe, e assesi nuk do të lejojë që energjia e cila duhet harxhuar jashtë të konsumohet brenda muslimanëve.

I uroj punë të mbarë dhe e lus Zotin e Madhëruar që puna e tij të jetë një bazë e fortë jo vetëm për muslimanët e kësaj kohe por edhe për brezat që do të vijnë pas nesh.

Në emër të redaksisë: Enis RAMA

AKTUALE

Dr. Jusuf Kardavi dhe Shiizmi **3-6**
Armët financiare të shkatërrimit masiv **7-12**

KËNDI IM

A e di ç'është nasihati?! **13-15**
Mendja e shëndoshë kundër duhanit **16-19**
Dialogu si aspekt vital i thirrjes islame **20-22**

AKIDE

Sqarimi i shirkut tek dijetarët e medhhebeve
Shafi, Maliki dhe Hanbeli **23-26**

FIKH

Talaku – divorci **27-31**

AVANCIMI PERSONAL

Veprimi **32-34**

FAMILJA

Gruaja ndërton jetën **35-37**
Shtëpia e besimtarit **38-41**

TEFSIR

Kurani shërim Hyjnor **42-44**

HADITH

Çdo bidat është humbje **45-47**

LIBRI

Prezantim i librit “Kujtime” **48-52**

BOTA ISLAME

Republika Popullore e Bangladeshit **52-53**

FETVA DHE KONSULTIME

Rreth haxhillëkut **54-56**

HISTORI

Çifutët në Palestinë **57-60**

REDAKSIA

Omer BERISHA – kryeredaktor

Anëtarë të redaksisë:

Ahmed KALAJA, Bekir HALIMI, Agim BEKIRI, Driton LEKAJ, Ali SHABANI, Ismail BARDHOSHI,
Talha KURTISHI, Bledar HAXHIU, Sedat SHABANI, Agron TERZIQI, Lulzim SUSURI, Genc PLUMBI, Zeki ÇERKEZI,
Enver AZIZI, Bashkim BAJRAMI, Bilal TEQJA.

Bashkëpunëtorë: Ekrem AVDIU dhe ENIS RAMA

Roald HYSA – redaktor gjuhësor

Halil BERISHA – redaktor teknik

Dorlir KRAJA (ENSARTDESIGN Studio) - ballina

Sedat RAMADANI - shpërndarje dhe marketing

Boton: Albislam

Adresa: rr: 110 nr: 5 | Çarshia e vjetër | Shkup 1000

email: revista@albislam.com

sms: +389 75 436 718 | fax&tel: +389 2 3230 827

Revista është e regjistruar pranë Agjencisë për

Informata të Maqedonisë nr. 02-124/2

ISSN: 1409-6250

Tirazhi: 2000

ABONIMI NJË VJEÇAR

Për Maqedoni: 600 den, Jashtë vendit: 20 euro

(në çmim janë të përfshira edhe harxhimet postare)

e-mail: albislam.abonues@gmail.com

ALBISLAM DOOEL

Xhirollogaria: 300000002770453

Komercijalna Banka A. D. – Skopje

Numri tatimor: 4030008038784

Abonimet me euro mund t'i bëni online nëpërmjet shërbimit
PAYPAL. Të dhënat mund t'i gjeni në www.albislam.com

DR. JUSUF KARDAVI DHE SHIIZMI

Nëse qëndrimi i Imamëve të Ehli Syneetit përgjatë historisë ka qenë refuzues ndaj shiitëve, nëse qëndrimi i Imamëve bashkëkohorë të Ehli Syneetit ndaj shiizmit është refuzues, dhe ky qëndrim tashmë edhe po plotësohet me qëndrimin e Universitetit të Az'harit dhe dr. Kardavit, pse qëndrimi i xhemateve të ndryshme tek shqiptarët dhe në Ballkan të mbetet akoma i papërcaktuar dhe i paunifikuar?!

SHKRUAN: BEKIR HALIMI

Tema e cila u hap në këtë muaj rreth qëndrimit të disa dijetarëve eminent në botën islame kundrejt shiizmit pati jehonë edhe në vendin tonë dhe brenda popullit tonë. Duke përcjellë disa debate që lindën rreth këtij problemi më detyruan edhe mua që të futem në këtë debat për të thënë disa fjalë, me shpresë se do të kenë rol pozitiv në kuptimin e kësaj problematike.

Fillimisht duhet theksuar se dr. Kardavi vjen nga ai grup dijetarësh, që qëndrimi i tij

kundrejt disa fenomeneve të shoqërisë islame është përshkruar si qëndrim i matur dhe më liberal.

Përvoja e tij në fushën e daves islame është shumë e madhe, njohja me problematikat e ndryshme fetare dhe akaidologjike gjithashtu e vjetër. Krejt këto parametra na japin të drejtën të konkludojmë, se reagimi i dr. Kardavit kundrejt shiizmit dhe ekspansionit të tyre nuk ka qenë momental, as i hovshëm, e as i pamatur mirë.

Qëndrimi i dr. Kardavit vjen në një kohë kur edhe hoxhallarët udhëheqës të shkollës më të vjetër islame, **Az'hari Sherifit** dolën me



një deklaratë si kjo kundër ekspansionit shiit në Egjipt. Madje ata edhe filluan një fushatë për edukimin e hoxhallarëve dhe popullit kundrejt kurtheve dhe mashtrimeve të shiitëve dhe misionarizmit të tyre në Egjipt.

Deklarata e dr. Kardavit është analizuar nga shumë njerëz, dijetarë, analistë, gazetarë, opinionistë etj., dhe disa e kanë akuzuar dr. Kardavin për nxitim dhe ndihmesë në ndezjen e fitnes mes synitëve dhe shiitëve, disa të tjerë të cilët janë konvertuar në shiizëm, për sabotim të unitetit islam, kurse disa të tjerë për vonim në marrjen e këtij hapi dhe sqarimin e këtij qëndrimi.

Mirëpo të gjithë ata kur i përmendin disa fakte për dr. Kardavin dhe për realitetin shiit, medoemos dalin me konstatimin se ky qëndrim është më se i saktë, edhe pse ndoshta pak i vonuar, kur dihet shumë mirë botërisht se dr. Kardavi ka qenë pjesë e përpjekjeve të vazhdueshme për afrim mes shkollës synite dhe shiite, vizitues i Iranit, është takuar shumë herë me kokat e tyre, madje njërin prej tyre e ka emëruar edhe si zëvendës të kryetarit të “Unionit Botëror të Dijetarëve Muslimanë”, institucion, të cilin ky e ka ngritur dhe pa të nuk do të kishte edhe ndonjë vlerë për t’u theksuar, krejt kjo tregon se ky dijetar i njeh shumë mirë për së afërmi këta njerëz dhe këtë shkollë, prandaj edhe reagimi i tij, i cili vjen pas krejt këtyre ofertave për afrim dhe unitet, është më se i drejtë dhe i saktë.

Fakti i dytë është realiteti shiit dhe qëndrimi i tyre praktik ndaj synitëve. Ata në kohën e përhapjes së njoftimeve nuk mund të vazhdojnë me avazin e vjetër të fshehjes së bindjeve dhe besimit të tyre, nëpërmjet institucionit të legalizimit të gënjeshtres, e cila quhet **“tukje”**, pasi të gjitha librat kryesore të tyre, qëndrimet historike dhe bashkëkohore, fetvatë e tyre në lidhje me synitët dhe bindjet dhe besimet synite janë publike për të gjithë dhe secili mund të bindet në vërtetësinë e pohimeve të dijetarëve synitë

“Nëse dr. Jusuf Kardavi i vlerëson shiitët si sekt bidati, ne si të tillë duhet t'i trajtojmë dhe kjo le të bëhet pikëtakimi ynë në lidhje me qëndrimin tonë rreth tyre...”

kundrejt tyre gjatë tërë historisë. Nëse ata si kusht të besimit të tyre vendosin besimin në “imamatin” dhe se mungesa e këtij kushti të besimit është shkak i mjaftueshëm për mosllogaritjen e një myslimani si besimtar, do të mjaftonte kjo për të shpallur si jomysliman shumicën dërrmuese të muslimanëve synitë.

Mos të harrojmë edhe një fakt shumë domethënës, që tregon dhe shpalos qartë qëndrimin armiqësor të shiitëve kundrejt synitëve, e ky është qëndrimi pro sulmeve dhe okupimeve të vendeve muslimane, sikurse ndodhi në Afganistan, në Irak, në Çeçeni dhe vënia në shërbim të planeve sioniste dhe antisynite në Liban. Ata jo vetëm që lejuan dhe ndihmuan okupimin e tokave muslimane nga forcat jo-islame, por edhe morën pjesë drejtpërdrejtë në masakrimin e mijëra muslimanëve synitë, duke ndryshuar kështu hartën demografike të shumë qyteteve në Irak.

Ky realitet ka depërtuar deri tek veshët dhe sytë e dijetarëve islam në botë po ashtu edhe tek dr. Kardavit, prandaj edhe ai nuk ka mundur të heshtë më tej dhe të vazhdojë akoma me thirrje jo-të sinqerta dhe joserioze për unitet dhe afrim, por ka vendosur që ta shpalli dhe ta publikojë një të vërtetë historike, për të cilën shumë njerëz dëshironin të mos jetë e tillë, mirëpo në fund na doli se ajo është mu ashtu si e kanë pohuar dijetarët islamë gjatë tërë historisë.

Muslimanët e Ballkanit në mënyrë masive e kanë pranuar Fenë Islame me ardhjen e Osmanlinjve, meqenëse faktet historike tregojnë për depërtimin e Islamit në këto troje edhe para Osmanlinjve, dhe normalisht me marrjen e Fesë Islame nga Osmanlinjtë kemi trashëguar edhe qëndrimin shumë refuzues dhe kundërshtues të bindjeve dhe besimeve shiite, meqë qëndrimi zyrtar i shtetit Osman dhe fetvatë e institucionit më të lartë fetar në atë perandori atëbotë “Shejhul-Islamit” kundrejt shiizmit ka qenë i prerë dhe i fuqishëm për refuzim dhe kundërvënien për shkak të besimeve dhe bindjeve devijuese të tyre dhe për shkak të dëmeve dhe tradhtive të ndryshme, që kanë bërë kundër Perandorisë së madhe Osmane.

Prandaj për këtë rast do të përmendim kalimthi vetëm një fetva të shejh Ebu Suudit, i cili mes tjerash thotë:

“Dijetarët e botës kanë konsensus... se ai që dyshon në mosbesimin e tyre edhe ai vetë është mosbesimtar”. (shiko: “El-Ukudud-Derijeti fi tenkihi El-Fetave el-Hamidije”, Ibën Abidin, 1/94-96).

Ajo që më habit shpesh është qëndrimi jo-konsekuent i disa teologëve dhe islamistëve tanë, të cilët për shumë çështje, që kanë të bëjnë më shumë me traditën, se sa me vetë fenë mbështeten në praktikatat e Osmanlinjve, kurse kur kemi të bëjmë me një temë që prek thelbin e fesë, i anashkalojmë ata dhe marrim qëndrime krejtësisht të panjohura për Imamët e medhhebeve apo hoxhallarëve tradicionalë të Umetit Islam!

Ajo që na intereson neve si shqiptar nga krejt kjo zhurmë e madhe që u bë në lidhje me deklaratën e dr. Kardavit kundër ekspansionit shiit është injorimi i kësaj deklarate nga shumë protagonistë të mendimit të dr. Kardavit në shumë çështje të fesë, gjë e cila na detyron të mendojmë se shiizmi dhe qëndrimi shumë liberal ndaj shiizmit të disa qarqe islame në trojet shqiptare, ose është shkujdes

i qëllimtë ndaj këtij fenomeni, ose paraqet ndonjë ndikim të fshehtë, i cili për momentin akoma nuk ka dalë në shesh tërësisht. Porse siç thonë: “më e ëmbla prej këtyre dy gjërave është e hidhur”.

Shpesh herë ndodh që gjatë debateve të ndryshme që bëhen në mesin e myslimanëve të trojeve shqiptare, apo edhe atyre ballkanike, kur tentohet të paraqitet një qëndrim akademik, i mbështetur në argumentet Kuranore dhe hadithet e sakta të Pejgamberit, salallahu alejhi ue selem, dhe në mendimet dhe qëndrimet e Imamëve të fesë, refuzohet me pretekstin se është në kundërshtim me atë që kemi gjetur tradicionalisht në vendin tonë, ose është në kundërshtim me medhhebin e Imam Ebu Hanifes, kurse ne të gjithë këtu jemi ithtarë të kësaj shkolle, dhe qëndrime të tilla akademike i etiketojnë si vehabizëm, jomedhhebizëm, formë devijante e paraqitjes së Islamit dhe e luftojnë me një ngulm dhe elan shumë të madh.

Do ta kisha kuptuar krejt këtë energji, krejt këtë refuzim, krejt këtë luftë të pakompromis, krejt këto kualifikime dhe etiketime ndaj kësaj qasjeje akademike dhe shkencore, po që se do të kishin një qasje të ngjashme edhe ndaj fenomenit shiizëm! Mirëpo ajo që është e vërtetë, e në këtë rast shumë e dhimbshme, është se qëndrimi i tyre ndaj fenomenit shiizëm, vazhdimisht përshkohet me tolerancë, mirëkuptim, arsyetim, madje disa herë me legalizim apo - Zot na ruaj- me favorizim ndaj tyre. Pa dyshim që një qasje e tillë selektive, nuk mund të karakterizohet me akademizëm, nuk mbetet vend për të folur për paanshmëri, e jo më për tradicionalizëm!

Nëse dr. Jusuf Kardavi i vlerëson shiitët si sekt bidati, ne si të tillë duhet t'i trajtojmë dhe kjo le të bëhet pikëtakimi ynë në lidhje me qëndrimin tonë rreth tyre.

Ehli Syneti nuk duhet të grinden mes veti (ihvan – selefi) rreth vlerësimit ndaj tjetrit

(shiitët), por ne duhet të kërkojnë sinqerisht pikat e përbashkëta fillimisht mes vetes, për të dëshmuar nëse janë të sinqertë në kërkimin e këtyre pikave të përbashkëta me tjetrin.

Këtu kam si qëllim edhe relativizmin dhe kalimin në heshtje të qëndrimit dhe kualifikimeve të dr. Kardavit rreth shiizmit dhe hapjen dhe imponimin e debatit rreth gabimeve eventuale të dr. Kardavit.

Nëse qëndrimi i Imamëve të Ehli Syneetit përgjatë historisë ka qenë refuzues ndaj shiitëve, nëse qëndrimi i Imamëve bashkëkohorë të Ehli Syneetit ndaj shiizmit është refuzues, dhe ky qëndrim tashmë edhe po plotësohet me qëndrimin e Universitetit të Az'harit dhe dr. Kardavit, pse qëndrimi i xhimateve të ndryshme tek shqiptarët dhe në Ballkan të mbetet akoma i papërcaktuar dhe i paunifikuar?!

Ata që e kundërshtojnë këtë qasje mbështeten në një teori të gabuar, e cila thotë: ta kërkojmë unitetin në çfarëdo forme qoftë, edhe nëse është në formë kontradiktore mes vetë!

Ose teoria tjetër e gabuar: Kundërshtimi dhe refuzimi i shiizmit do të ndezë luftë.

Këto janë teori të fabrikuara në vende të ndryshme dhe nuk janë të sakta, sepse dijetarët islamë përgjatë historisë e kanë kritikuar shiizmin, mirëpo asnjëherë ata nuk kanë thirrur për luftë kundër tyre, madje as që ka ndodhur ndonjëherë luftë mes tyre për shkak të këtyre debateve.

Ata që u besojnë këtyre teorive në raste të tjera thërrasin në lirinë e mendimit dhe divergjencave, madje edhe në detyrimin e kritikës dhe kundërshtimit, por me kulturë dhe edukatë, e kur të hapet debati rreth shiizmit, imponojnë mendimin e tyre, nuk i pranojnë mendimet e tjera dhe e luftojnë kategorikisht mendimin tjetër!

Çka të themi në këso rastesh?!

Ne si shqiptarë në këtë debat nuk mund ta injorojmë edhe faktin që ka të bëjë me ne dhe

mëvetësinë e shtetin tonë, Kosovës. Apo e thënë ndryshe lidhja mes neve dhe Iranit nën prizmin e mospërkrahjes së përpjekjeve dhe orvatjeve të popullit të Kosovës që të pavarësohet nga Serbia, raportet shumë të mira të Iranit me Rusinë dhe Serbinë, mospranimi i shtetit të Kosovës, përkrahja e rezolutës për hedhje në Gjyqin Ndërkombëtar të pavarësisë së Kosovës etj., veprime këto, që nuk tregojnë ndonjë solidaritet fetar, të cilin është dashur së paku për shkaqe diplomatike ta shfaqin në rastin e Kosovës.

Sidoqoftë nuk qëndron fitneja në kritikën, por në heshtjen, sepse kritika dhe sqarimi i fenomenit janë në shërbim të vërtetës, kurse sqarimi i të vërtetës është vepër fisnike, në të cilën beson çdo njeri intelektual dhe fisnik.

Nëse heshtja shkakton mbulimin e të vërtetës dhe injorimin e saj, deformimi i të vërtetës shkakton devijimin e njerëzve dhe çoroditje në rruzullin tokësor.

Patjetër duhet të çregjistrojmë nga koka ndërlidhjen mes fitnes dhe kritikës për të sqaruar të vërtetën, sepse kjo nuk është fitne, përveç se në mendjen e atij që e dominon iluzioni, ose që ngre ndonjë parullë nga e cila përfiton materialisht.

Analizat, debatet dhe qëndrimet rreth fenomeneve të caktuara, në rastin konkret, fenomeni shiizëm, janë nga prizmi intelektual dhe akademik dhe s'ka të bëjë aspak me veprime të dhunshme apo konkrete kundër tyre, dhe kurrë nuk do të kishim dashur që nga kjo trajtesë të nxirret një përfundim i tillë. Këtë e themi duke kuptuar brengën e sinqertë të disa bijve të popullit tonë dhe trumbetimin krijësisht të pavend të disa "analistëve" tanë, të cilët kinse japin alarmin për mundësinë e konflikteve vëllavrasëse mes shqiptarëve, duke theksuar elementin fetar në identitetin kombëtar dhe duke sjellë si shembull disa raste dhe ngjarje, që ndodhin në botën islame. ■

ARMËT FINANCIARE TË SHKATËRRIMIT MASIV



Nëse marrim në konsideratë faktin se ekonomia amerikane rëndon nga pesha e borxheve të jashtëzakonshme, të mbledhura për vite me radhë, të cilat i kalojnë 30 trilion dollarët, në sektorin publik dhe atë privat, dhe se kriza e sigurimeve shoqërore dhe e kompensimit të pensionistëve ka filluar të shfaqet në horizont, për të cilën parashikohet të arrijë kulmin e saj në vitin 2012, padyshim që masa e katastrofës, që pret ekonomia amerikane në vitet e ardhshme mund të jetë e paimagjinueshme.

SAMI ES-SUEJLIM

Para afro gjashtë vjetësh, saktësisht në shkurt të 2003 **Uarren Bafet** (Warren Buffett)¹, një nga njerëzit më të pasur të botës dhe një nga investorët dhe biznesmenët më të suksesshëm në fjalimin e tij të përvitshëm përpara sesionit të përgjithshëm të kompanisë së tij

“Berkshire Hathaway”, i cilësoi derivatet (përftimet) financiare si “mina me sahat, si për ata që punojnë me to, por edhe për vetë ekonominë.” Ai gjithashtu shtoi se: “Ato i ngajnë skëterrës, në të cilën është e lehtë të hysh, por gati e pamundur të dalësh prej saj.” Po ashtu ai shtoi duke thënë: “Panorama e përgjithshme paraqitet e rrezikshme dhe po drejtohet drejt më së keqes...”, dhe më pas ai e mbylli duke thënë: “Ne kemi bindjen se

¹ Warren Buffett është klasifikuar nga revista "Forbes" si njeriu më i pasur i botës për gjysmën e parë të vitit 2008.

derivatet (financiare) janë armë financiare të shkatërrimit masiv, që mbartin rrezeqe, deri tani të padukshme, por me një potencial vdekjeprurës.”²

Kur Bafet i lëshoi këto deklarata, disa u habitën dhe të tjerë mbajtën një qëndrim mosaprovues, sepse derivatet financiare –sipas tyre– janë mjete të shpikura për të menaxhuar rrezikun financiar dhe për ta shpërndarë atë në mënyrë të barabartë, duke e vënë kështu atë nën kontroll dhe duke e pakësuar atë. Por ditët në vijim –për fat të keq– vërtetuan largpamësinë e këtij njeriu dhe saktësinë e intuitës së tij. Kriza financiare, e cila ka përfshirë sot botën, një nga shkaqet e saj kryesore ka edhe derivatet financiare dhe në veçanti derivatet kreditore (**credit derivatives**), ose instrumentet e shkëmbimit të rrezikut kreditor (**credit default swaps**).

Por çfarë janë këto derivate? Si na kanë çuar ato në krizën që po përjetojmë ne sot?

Derivatet kreditore

Derivatet janë instrumente financiare për të shkëmbyer rrezikun. Derivatet kreditore, ose instrumentet e shkëmbimit të rrezikut kreditor janë në thelb kontrata sigurimi: ku njëra palë (banka që jep kredi), e cila paguan një tarifë të caktuar në këmbim që pala tjetër (kompani sigurimi) ta garantojë se do t’i paguaj palës së parë vlerën e kredisë së siguruar, nëse debitori e ka të pamundur ta shlyejë atë.

Si ka ndikuar ky instrument në shkaktimin e krizës financiare?

Nëse një bankë i jep kredi një njeriu, banka është e kujdesshme, që të marrë të gjitha garancitë e mundshme që kredia do të shlyhet, sepse nëse huamarrësi falimenton ajo që dëmtohet është banka. Por çfarë ndodh nëse banka arrin ta

“Pra, kriza filloi nëpërmjet kamatës (mashtimit nëpërmjet interesit të ulët), më pas përparoi në kumar, ku si njëra si tjetra e ushqenin njëra-tjetrën për të përfunduar pastaj në katastrofë...”

sigurojë këtë kredi dhe ta zhvendosë rrezikun e borxhit tek një palë e tretë? Në këtë rast banka nuk do të dëmtohet nga falimentimi i debitorit, sepse një palë e tretë tashmë del garant për t’i paguar bankës shumën e kredisë së plotë, nëse ndodh falimentimi i debitorit. Për këtë arsye banka nuk ka ndonjë motiv të fortë për t’u siguruar për aftësinë e pagesës nga ana debitorit. Ndaj edhe bankat me lehtësi të madhe u japin kredi shtresave me aftësi të ulët për shlyerjen e borxhit, sepse rrezikun e ka marrë përsipër dikush tjetër, në të shumtën e rasteve kompanitë e sigurimit dhe fondet e rezervës.

Sigurimi i kredive i ka nxitur bankat që të japin kredi, më pas edhe ta shesin kredinë në formë bonosh bashkë me sigurimin e këtyre bonove. Ai që i blen këto bono në fakt blen kredi të siguruara, ndaj dhe atij nuk i intereson nëse debitori ka mundësi ta shlyejë kredinë apo jo. Përderisa kreditë janë të siguruara atij nuk i intereson aftësia e pagimit apo mundësia e debitorit për të garantuar kredinë e marrë, e rëndësishme për të është tarifa që përfiton banka dhe shoqëritë e tjera financiare, nga operacionet e financimit

² <http://www.berkshirehathaway.com/letters/2002pdf.pdf> fq.14.

dhe nxjerrjes së bonove dhe ç'ka lidhje me to. Nëse nuk do të ishte në mes siguracioni, ky rreth vicioz nuk do të mund të fryhej në mënyrë kritike deri në këtë pikë, sa nuk do të ishte e mundur të krijoheshin ato që quhen **“asete (pasuri, vlera) të helmuara”**, të cilat janë vrima e rrezikut në flluskën e sapunit dhe terreni i brishtë mbi të cilin janë ngritur bonot e kredive.

Këto derivate financiare kanë çuar në përqendrimin e rreziqeve, në vend që të çonin në copëtimin e tyre, kanë çuar në fshehjen e tyre në vend që t'i pakësonin ato.

Lind pyetja çfarë interesi kanë kompanitë e sigurimeve dhe fondet e rezervës që japin garanci për këto kredi?

Së pari, tarifat monetare që ato përfitojnë janë joshëse, nëse kredia e siguruar është e madhe. Po kështu edhe motivet e hyrjes në këtë operacion financiar mbështeten në një sasi të ardhurash të realizueshme, ndaj sa më shumë të shtohen tarifat shtohen edhe motivet.

Së dyti, për sa kohë çmimet e tregut imobiliar (toka, shtëpi, godina) apo atij të aseteve (pronave), për të cilat jepet paraja është në rritje, nuk ka për të pasur rreziqe a ngecje, sepse debitori mund ta rifinancojë godinën (apo tokën) duke marrë një kredi të re, ose mund ta shesë atë për të shlyer borxhin dhe për të marrë një fitim shtesë.

Çmimet e tregut të shtëpive në SHBA kanë qenë vazhdimisht në rritje, që nga viti 2000, ndaj dhe nuk ka pasur shkak për t'u trembur në këtë drejtim. Këtu kuptohet sesi u rrit flluska e pengut imobiliar. Sigurimi nxit në dhënien e huave, huadhënia kontribuon në rritjen çmimeve të shtëpive (tokave, godinave), rritja e çmimeve nxit në dhënien e sigurimeve për kreditë, sepse rreziqet janë të pakta, çka

bën të nxitet edhe më tepër huadhënia... e kështu në vazhdimësi. Kështu që rrethi i huadhënies dhe i sigurimeve ushqejnë njëra-tjetrën, gjë që çoi në fryrjen e shumëfishtë të flluskës dhe në veçanti gjatë vitit 2004 deri në fillimet e vitit 2007, derisa në verën e 2007 flluska plasi dhe filloi zinxhiri i krizës, efekti domino.

Së treti, pala siguruese mund t'i shesë rreziqet te palë të tjera, ashtu siç janë ose me rreziqe të tjera plus dhe këto në formë bonosh, që u ngajnë bonove të kredive dhe për këtë ajo përfiton tarifa shtesë. Edhe ai që i blen këto bono mund t'i shesë ato duke i kaluar kështu rreziqet te të tjerë njerëz. Kështu pjesëmarrësit në treg do ta hedhin sa te njëri, sa te tjetri topin e rrezikut dhe çdonjëri shpreson që topi të mos i plasë në duart e tij. Sa më i madh të jetë tregu dhe sa më shumë lojtarë të ketë në të, aq më e vogël është mundësia, që ndjen gjithsecili, se topi i rrezikut do të plasë në duart e tij, ndaj rritet edhe pranimi i këtyre rreziqeve. Për këtë arsye fryrja e tregjeve është në interes të spekulatorëve, kjo shpjegon edhe faktin se pse tregu i rreziqeve të siguruara u shumëfishua më shumë se tetë herë gjatë viteve 2004 -2007, derisa arriti në 62 trilion dollar.

Kazinoja më e rrezikshme në botë

Tregu i rreziqeve kreditore nuk do të ishte rritur në këtë masë, nëse blerja e

“Vetëm një lëkundje e lehtë mund të çojë në falimentimin e shumë shoqërive, kompanive dhe individëve të zhytur në borxhe...”

kredive do të ishte kufizuar te bankat, të cilat janë në fakt ato që i kanë dhënë kreditë. Ajo që i dallon derivatet kreditore është fakti që çdo njeri mund ta blejë kredinë nga kushdo tjetër, edhe nëse asnjëri prej tyre nuk ka asnjë lloj lidhje me kredinë e financuar për imobiliaret (shtëpitë, tokat), kështu që kontrata në të vërtetë kthehet në një bast (loto) ndërmjet dy palëve, e gjitha kjo e varur nga ajo se çfarë do t'i ndodhë palës së tretë, që në këtë rast është debitori (borxhliu). Nëse debitori falimenton, pala shitëse i jep kompensimin palës blerëse, ndërkohë që as huadhënësi, as huamarrësi nuk marrin gjë. Kjo gjë ishte ajo që e shtyu analistin ekonomik të uebsajtit të CNN-it ta quajë tregun e derivateve kreditore, si “kazinonë më të madhe në botë”. Edhe vetë kandidati republikan Xhon Mekein e pranoi se kultura e kazinosë ka dominuar mbi Uoll Stritin (Wall Street). Por sidoqoftë ky treg ndryshon nga kazinotë në aspekte të rëndësishme. Si për shembull: kazinotë u nënshtrohen kontrollit dhe mbikëqyrjes nga ana organeve e shtetërore, në shtetet ku ato lejohen, ndërsa tregjet e derivateve nuk u nënshtrohen asnjë lloj kontrolli, apo organizimi të drejtpërdrejtë nga qeveria amerikane.

Po kështu kazinoja dallon nga tregu i derivateve në një aspekt tjetër akoma më të rëndësishëm, çdo grup lojtarësh në kazino e varin fitoren e tyre tek ruleta, që u përket atyre dhe nuk kanë asnjë lloj lidhje me të tjerët. Nuk ka asnjë lloj lidhje ndërmjet grupeve të ndryshme në kazino, ndërsa në tregjet e derivateve, që të gjithë janë të lidhur me njëri-tjetrin dhe të gjithë në fund fare janë të lidhur me tregjet dhe në veçanti tregjet imobiliare. Çdo rënie në tregun e shtëpive (tokave, godinave) shpie në humbje të një pjese të madhe të lojtarëve. Shtu këtu që çdo dollar humbje

në tregun imobiliar do të çojë në një humbje të shumëfishtë në tregun e derivateve. Sasia e borxheve të vëna në lojë në qarkullim, ka arritur vlerën e 62 trilion dollarëve në fund të 2007, ndonëse huaja për blerjen e pronave të patundshme në të gjithë SHBA nuk i kalon 10 trilion dollarët, ndërkohë që kredia e huas së ulët vlerësohet rreth 1.3 trilion dollarë.

Nëse derivatet e veçanta për asetet (pronat), me huat më të ulëta për t'u paguar arrijnë vlerën e rreth 1/3 së tregut të derivateve kreditore, kjo do të thotë se për çdo dollar që jepet borxh me të luhet rreth dhjetë herë. Gjithashtu kjo do të thotë se në rast mospagimi nga ana e borxhliut, humbja nuk do të kufizohet vetëm te huadhënësi i tij, por do të kalojë edhe te spekulatorët e tregut, humbja e të cilëve mund të jetë dhjetë herë më e madhe sesa humbja reale.

Dallimi më i rëndësishëm dhe më i rrezikshëm ndërmjet kazinosë dhe tregut të derivateve është natyra e lojtarëve. Në kazino lojtarët janë individë, që më së shumti vënë në lojë pasurinë e tyre, ndërsa në tregun e derivateve lojtarët janë shoqëri financiare dhe banka, të cilat vënë në lojë paratë e kreditorëve, investitorëve dhe huadhënësve, që u përkasin shoqërive të tjera financiare. Humbja do të jetë në dëm të të gjithë ekonomisë dhe jo vetëm në dëm të kumarxhinjve. Nëse marrim në konsideratë faktin se ekonomia amerikane rënkon nga pesha e borxheve të jashtëzakonshme, të mbledhura për vite me radhë, të cilat i kalojnë 30 trilion dollarët, në sektorin publik dhe atë privat, dhe se kriza e sigurimeve shoqërore dhe e kompensimit të pensionistëve ka filluar të shfaqet në horizont, për të cilën parashikohet të arrijë kulmin e saj në vitin 2012, padyshim që masa e katastrofës, që pret ekonomia amerikane në vitet e

ardhshme mund të jetë e paimagj-nueshme.

Kriza ligjore

Kriza aktuale është pasojë e operacioneve të gabuara financiare dhe e praktikave të dështuara, por këtyre veprimeve u ka paraprirë dhe u ka hapur rrugë një ambient ligjor, që iu përshtat atyre.

Tregu i derivateve kreditore pothuaj nuk ekzistonte në fundin e viteve '90 të shekullit të kaluar, por ai filloi të rritej në mënyrë të jashtëzakonshme në fillim të këtij shekulli, pasi kongresi amerikan, i cili dominohej nga republikanët aprovoi një ligj në vitin 2000: **“Commodity Futures Modernization Act”**, i cili ndalon organizimin dhe limitimin e tregjeve të derivateve, madje i përjashton ato edhe nga ligjet e bixhozit, që ka në disa shtete të ndryshme. Për këtë arsye derivatet kreditore nuk cilësohen në kontratat dhe marrëveshjet ligjore si sigurime (insurance), ndonëse në të vërtetë ato janë të tilla, sepse kështu ato do t'i nënshtrohen ligjeve të sigurimeve, por ato cilësohen si shkëmbime (swaps), që të ato përfitojnë nga ky ligj.

Në vitin 1999 një tjetër ligj i parapriu këtij të vitit 2000 ligji **“Gramm-Leach-Bliley Act”**, i cili lejonte që bankat tregtare të hynin në tregun e këmbimit valutor dhe atë të aksioneve, e që ishte ndaluar nga një ligj i nxjerrë para rreth 70 vjetëve **“Glass-Steagall Act”**.

Dhe kështu me fillimin e shekullit XXI u hap plotësisht dera për bizneset më të rëndësishme financiare, që janë bankat, për t'i hyrë aventurës me instrumentet më të rrezikshme financiare, e që janë derivatet (përftimet financiare nga vetë paratë) dhe në asetet më të rëndësishme ekonomike, në tregun imobiliar (pronave

të patundshme). Si rezultat vetëm në pak vite bota u bë dëshmitare e katastrofës më të keqe financiare brenda 70 vjetëve..., dhe etapave të saj akoma nuk u ka ardhur fundi.

Merrni mësim, o njerëz

Rrënjët e krizës nga e cila po vuan sot bota filluan nga sektori i financës dhe u frynë po nëpërmjet saj, por për fat të keq në fund fare ai që paguan haraçin është sektori i prodhimit dhe masa e popullit. Fillimi nisi nga ulja artificiale e normës së interesit në fillim të shekullit, çka nxiti në zgjerimin e huamarrjes pa pasur ndonjë shtim real të vlerës monetare apo ndonjë rritje në prodhim. Rezultati që një filuskë në tregun e imobiliareve. Këtë e shoqëroi shpikja e derivateve financiare, e cila neutralizoi rreziqet e huadhënies, kështu që tashmë huadhënësi nuk e ndjente më përgjegjësinë e kredisë që jepte dhe të mundësisë së debitorit për të shlyer, nga kjo lojë erdhën më pas praktika negative, që i tërhiqnin klientët dhe i mbysnin ata në borxhe.

Pra, kriza filloi nëpërmjet kamatës (mashtimit nëpërmjet interesit të ulët), më pas përparoi në kumar, ku si njëra si tjetra e ushqenin njëra-tjetrën për të përfunduar pastaj në katastrofë.

Edhe sikur fetë qiellore të mos e kishin ndaluar kamatën dhe kumarin, krizat e njëpasnjëshme që shkaktohen për shkak të tyre do të mjaftonin si arsye, që këto të dyja të ndaloheshin.

Problemi i kamatës është shkëputja e financimit nga aktiviteti prodhues, aktivitet i cili prodhon shtimin real të vlerës. Kamata bën ndarje në mes rritjes së borxhit dhe rritjes së pasurisë. Padyshim që rritja e borxhit është shumë më lehtë, sesa shtimi i pasurisë, sepse nuk kërkon më shumë sesa aprovimin e dy palëve,

huadhënësit dhe huamarrësit. Por rritja e pasurisë dhe e bollëkut kërkon, përveç aprovimit të të dy palëve profesionalizmin, përvojën, novacionin, njohjen dhe prodhimin. Dhe nëse rritja e borxhit ndodh më shpejt sesa rritja e prodhimit, shërbimi ndaj borxhit do të rritet çka do të çojë në tejkalimin e të ardhurave, për t'u kthyer kështu borxhet në hemorragji e aktivitetit ekonomik dhe një gur i rëndë mbi të, në vend që borxhet të jenë një faktor ndihmues në rritjen e prodhimit dhe zhvillimit ekonomik dhe si rezultat i shpërbërjes së borxhit gjendja ekonomike bëhet e brishtë dhe shumë e ndjeshme nga lëkundjet e tregjeve dhe e çmimeve. Vetëm një lëkundje e lehtë mund të çojë në falimentimin e shumë shoqërive, kompanive dhe individëve të zhytur në borxhe.

Ndërsa për sa i përket kumarit dhe basteve, që të gjithë e dinë, se ato nuk japin asnjë vlerë shtesë në aktivitetin ekonomik, por paqartësia ka ardhur si rezultat i përfytyrimit se shkëmbimi i rreziqeve mund të ngrejë kapacitetin financiar dhe më pas edhe prodhimin. Por shkëmbimi i rreziqeve i shkëputur nga prona, shpie në atë që njihet si rrezik moral (moral hazard), të cilat u shfaqën mjaft qartë në veprimet e papërgjegjshme, që çuan në krizën e huamarrjes për blerjen e pronave të patundshme. Në mungesë të mbartjes së rreziqeve të pronës, humbet përgjegjësia dhe bashkë me të edhe kontrolli moral dhe kështu tregu kthehet në një arenë bastesh dhe shfrytëzimi. Nëse tregu kthehet në një fushë lotarie nuk ka asgjë që e ndal rritjen dhe fryrjen e tij, përveç gatishmërisë së palëve spekuluese për të mos e bërë këtë. Ashtu si për kamatën edhe bastvënia nuk kërkon më shumë sesa një aprovim në mes dy palëve, ku njëra palë do t'i paguajë palës tjetër një

shumë të hollash nëse ndodh rreziku, kundrejt një tarife të caktuar. Kostoja fillestare e bastit është e kufizuar ndaj nuk ka ndonjë pengesë, që të mos e lejojë atë të zgjerohet dhe të fryhet. **Rezultati në të dyja rastet, si nga kamata edhe nga kumari është i njëjti: shumëfishimi i detyrimeve dhe i borxheve larg pasurisë së vërtetë, çka sjell atë që quhet piramidë e përmbysur, ku male të tëra borxhesh peshojnë mbi një bazament të vogël pasurie. Me shtimin e këtyre borxheve baza do ta ketë të vështirë ta mbajë peshën e saj dhe kështu humbja pas rrëzimit të saj do të jetë e shumëfishtë.**

Për këtë arsye Feja Islame në legjislacionin e saj e ka të ndaluar kamatën dhe mashtrimin financiar, duke i konsideruar ato si dy praktika të ndaluara. Po ashtu dispozitat islame përmbajnë edhe norma të hollësishme, që ndalojnë rrugët që të shpien te këto praktika, siç është moslejimi i shitjes së borxhit, ndalimi i një fitimi për të cilin nuk mban garanci dhe përveç këtyre, të tjera në themel janë të lejuara. Për shkak të ekzistencës së këtyre rregullave, nuk mund të shfaqet piramida e përmbysur e borxheve me pasurinë, gjë që e dallon sistemin kapitalist. Ekonomia qëndron si një godinë e ekuilibruar, e qëndrueshme që mbështetet mbi një bazë të gjerë pasurie, tek e cila mbahet edhe një shtresë e kufizuar e borxheve dhe e detyrimeve. Ky model bashkon ndërmjet qëndrueshmërisë dhe prodhimit, sepse çdo zgjerim i borxheve shoqërohet nga një zgjerim i njëjtë me pasurinë. Ekonomia islame mbështetet mbi parimet e tregut, që pajton me dispozitat e fesë, me moralin, mbi parime të qarta e që shtyjnë drejt novacionit dhe zhvillimit e jo drejt krizave dhe tronditjeve financiare. ■

Përktheu: Justinian TOPULLI



“Mos këshillo me kusht që gjithësi të pranohet këshilla jote, e as mos ndërmjetëso me kusht që gjithësi të merret parasysh ndërmjetësimi yt, por këtë bëje me dëshirën që të bësh mirë, të kryesh detyrimin dhe të angazhohesh për të mirën e përgjithshme.”

DR. MUHAMED IBRAHIM EL-HAMED

Fjala **“en-nasihah”** është një fjalë shumë e madhe inspiruese, e cila përmban në vetvete kuptimet madhore të dashurisë, singëritetit, besnikërisë, mëshirës, dhembshurisë, dëshirës për perfeksion, si dhe shumë kuptime fisnike që janë të përafërta me këto. Sipas këtij shpjegimi, nuk është aspak çudi, që e tërë feja të jetë e përkufizuar me nasihatën, sikurse na tregohet në hadithin e shënuar në Sahihun e Muslimit nga transmetimi i

Temim ed-Dariut, në të cilin i Dërguari i Allahut ka thënë: *“Feja është nasihat.”* “Për kë, o i Dërguar?”, e pyetën ata. Ai tha: *“Për Allahun, Librin e Tij, të Dërguarin e Tij, prijësit e muslimanëve dhe masën e gjerë të tyre.”*¹

Muslimanët e vërtetë janë të singertë ndaj Allahut, duke e besuar Atë, duke i kryer detyrimet ndaj Tij dhe duke qenë të nënshtruar dhe robëruar plotësisht ndaj Tij, si në pamjen e jashtme ashtu edhe në brendinë e tyre. Singëriteti i tyre ndaj Librit të Allahut manifestohet me interesimin tyre për të, duke e lexuar,

¹ Sahihu Muslim nr. 55

duke e mësuar përmendësh, duke meditar rreth kuptimeve të tij, si dhe duke vepruar sipas udhëzimeve të tij dhe duke i ftuar njerëzit në atë udhëzim. Singëriteti dhe besnikëria e tyre ndaj të Dërguarit të Allahut, paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të, bëhet i dukshëm nëpërmjet dashurisë ndaj tij, respektit, pasimit të rrugës së tij, përudhjes me udhëzimin e tij, mbrojtjes dhe përkrahjes së tij, si dhe dhënies përparësi fjalës së tij para fjalës së kujtdo tjetër prej njerëzve.

Singëriteti ndaj prijësve të besimtarëve – duke filluar nga instancat më të larta e deri tek udhëheqësit e rangut të ulët, që kanë legjitimitet juridik – shprehet me pranimin e ligjshmërisë së tyre, duke qenë të dëgjueshëm ndaj tyre aty ku e kanë mirë dhe me vend, duke dhënë maksimumin për t'i udhëzuar nga e mbara, duke i përkujtuar për atë që është e mirë dhe e dobishme për ta dhe për umetin në përgjithësi, dhe duke ua tërhequr vëmendjen nga ajo që është e dëmshme për ta apo për umetin.

Ndërsa besnikëria dhe dashuria për masën e gjerë të muslimanëve bëhet e dukshme duke i dashur ata, duke ua dëshiruar të mirën, duke u angazhuar për mirëqenien e tyre të përgjithshme, duke e urryer të keqen për ta dhe nëpërmjet mënjanimi të faktorëve që ndikojnë që e keqja të ndodhë, duke u angazhuar që ajo të mos i godasë ata në asnjë mënyrë. Singëriteti i tyre ndaj masës manifestohet edhe nëpërmjet mësimi të të paditurve, vetëdijësimi të të shkujdesurve, këshillimit të tyre me atë që u bën dobi në këtë botë dhe në tjetrën, duke bashkëpunuar me ta në bamirësi dhe devotshmëri.

Nëse singëriteti dhe besnikëria ndaj komunitetit është në këtë pozitë, atëherë çdo i mençur duhet të pajiset me të, t'i

“Një pjesë e madhe e njerëzve mendojnë se këshilla është një përgjegjësi prej së cilës duhet të çlirohesh në çfarëdo forme...”

vlerësojë ashtu si duhet dhe të kuptojë mënyrat më efikase të realizimit dhe jetësimit të këtyre elementeve. Këtu, në mënyrë shumë të natyrshme, nuk kemi si qëllim të zgjerohemi në shpjegime, por vetëm do të japim disa shenja për çështje të rëndësishme, që kanë të bëjnë me këtë temë.

Kur të flasim për nasihatën (apo këshillën, si e përkufizojnë disa, E. A.), ajo që duhet gjithsesi të theksojmë është se **nasihati është ndjenjë e mëshirës për atë që i ofrohet ky nasihat**, si dhe t'i dëshirosh të mirën atij, e assesi nuk është barrë prej të cilës, ai që e jep atë (këshillën, nasihatën) mundohet të lirohet me çdo mënyrë. Pra, ai që e jep nasihatën duhet të ketë parasysh kuptimin e mëshirës, dëshirimit të së mirës, tendencës për përmirësim, e kjo gjithsesi do ta detyrojë atë që të jetë më i butë, më i sjellshëm, më tolerant dhe më korrekt. Kjo nënkupton edhe që këshilla kur jepet nuk do të thotë që doemos do të pranohet prej tjetrit dhe nëse ky nuk e pranon të nënçmohet, shahet apo ofendohet, duke u akuzuar për arrogancë apo mendjemadhësi. Ibën Hazmi, Allahu e mëshiroftë, thotë: “Mos këshillo me kusht që gjithsesi të pranohet këshilla jote, e as mos ndërmjetëso me kusht që gjithsesi të merret parasysh ndërmjetësimi yt, por këtë bëje me dëshirën që të bësh mirë, të kryesh

detyrimin dhe të angazhohesh për të mirën e përgjithshme.”

Ajo që e bën këshillën më të pranueshme është shumëllojshmëria e metodës në ofrimin e saj, si p.sh., dhënia e saj me maturi, parathëniet e bukura që e zbusin zemrën, duke e lavdëruar atë që e këshillon, duke ia përmendur paraardhësit e tij të mirë, si dhe duke pasur kujdes nga pezmi që mund t'i shkaktohet nëpërmjet çfarëdo forme nënçmimi, ofendimi e të ngjashme me to. Në këtë mënyrë arrijmë t'ia hapim zemrën dhe t'ia lehtësojmë pranimin e këshillës. Një vërejtje të veçantë duhet të bëjmë lidhur me metodën e dhënies së këshillës, sepse kjo është një gjë e madhe, që pakkush di ta bëjë si duhet, ngase një pjesë e madhe e njerëzve mendojnë se këshilla është një përgjegjësi prej së cilës duhet të çlirohesh në çfarëdo forme, duke mos marrë parasysh rrethanat, kohën, rregullat, e as gjendjen e njerëzve dhe emocionet e tyre. Sipas fesë së Allahut, ai që jep këshillë duhet të jetë i pajisur me dije, mençuri, arsye, zemërgjerësi dhe vetëpërmbajtje. Nëse nuk i ka këto virtyte, atëherë pritet që gabimi ta arrijë më shpejt atë, sesa suksesi.

Mund të themi se nuk ka në mesin e virtyteve të larta, gjë më të ndjeshme, më të saktë dhe më madhore se sa këshilla. Nuk është çudi, sipas kësaj, që disa njerëz të pranojnë këshillën e dikujt me zemër të qetë ashtu si pret lulja pikën e shiut, apo i eturi ujin e këndshëm. Ndërsa nuk e pranojnë këshillën e tjetrit dhe këshilla e tij kalon nëpër zemrën e tjetrit, sikurse kalon pika e shiut nëpër rrasën e gurit. Duhet vërejtur se shumë pak këshillohemi në këtë pikë, e kjo është pasojë e shkuarjes larg në atë që nuk është e qëlluar dhe e saktë dhe heqjes dorë nga ngritja dhe përmirësimi i vazhdueshëm.

Një prej të metave të njerëzve është edhe kryelartësia përballë këshillës dhe kritikës konstruktive, e cila mund të burojë nga njeriu i singertë dhe i ditur, por që nuk has në veshë të hapur e as në zemra të gjera, e kështu ai i këshilluari lartësohet dhe bëhet arrogant dhe e refuzon pranimin e këshillës, duke vazhduar kësisoj në gabimin e tij dhe duke e bërë më të vështirë përmirësimin e vetes.

Dhe në fund, parapëlqehet që atij që i ofrohet këshilla ta pranojë atë, në mënyrë që të rriten vlerat dhe të shtohet burrëria e tij. Madje, ai që synon përkryerjen – sidomos nëse është prijës i respektuar – duhet që prej atyre që i ka përreth vetes të kërkojë që të hulumtojnë të metat e tij dhe t'ia bëjnë të njohura ato, sepse kjo do t'i mundësonte atij, që të lirohet dhe pastrohet prej tyre. Ai madje, atij që i tërheq vërejtjen për të metat e tij duhet t'i jetë mirënjohës dhe ta pranojë me dashamirësi dhe zemërgjerësi. Këtë duhet ta konsiderojë më dashamirës sesa atë që e lavdëron vazhdimisht dhe nëse vepron kësisoj, shumë njerëz do të angazhohen në dhënien e vërejtjeve e kjo do të çojë drejt përmirësimit të tij. Nëse në të kundërtën e çon kokën lart dhe nuk pranon këshillat dhe vërejtjet e të tjerëve, duke menduar se po e nënçmojnë, duhet të merret me vetveten dhe ta detyrojë të ndjekë rrugën e përmirësimit dhe të pastrimit nga të metat, e jo t'i mbulojë ato sikur të mos ekzistojnë. ■

Përktheu: Ekrem Avdiu

MENDJA E SHËNDOSHË KUNDËR DUHANIT



sipas disa zbulimeve del se shumë kompani, që merren me prodhimin e cigareve, kompanive shëndetësore, të cilat merren me analizën e gjërave të ndryshme shëndetësore, ju dhurojnë miliona vetëm e vetëm, që të shkruajnë një efekt pozitiv, që mund të ketë një cigare

SHKRUAN: AGRON KURTISHI

Ndërsa numri i duhanpirësve në shumë vende perëndimore, si p.sh., në SHBA etj., me anë të punës së madhe bindëse që bëhet kundër duhanit dhe me anë të fushatave të ndryshme reklamuese anti-duhan ka arritur të ulet, konsumi i duhanit te muslimanët për fat të keq është shtuar dhe ka arritur të shndërrohet në një fenomen të pakuptueshëm negativ.

Nga fundi i shekullit XIX Universiteti i Az'harit ka nxjerrë një vendim juridik, që duhani (për shkak të aromës së keqe që mbart me vete) të llogaritet si **Mekruh** (e urryer). Sot ky vendim llogaritet si i vjetruar, për shkakun se: **së pari**, konsumimi i duhanit në atë kohë nuk ka qenë fenomen

masiv dhe **së dyti**, pasojat e dëmshme të duhanit nuk ishin hulumtuar akoma.

Ndër të tjera janë edhe këto shkaqet, që nga shumica absolute e dijetarëve muslimanë, duke futur këtu edhe dijetarët e Universitetit të Az'harit, të llogaritet pirja e duhanit si haram. Për një musliman të mirëfilltë, i cili ndjek rrugën e Allahut edhe vendimi si mekruh do të ishte i mjaftueshëm dhe këta persona do të duhej të distancoheshin nga duhani. Ata muslimanë që kanë frikërespekt ndaj Allahut kjo gjë nuk do t'ua lente ndërgjegjen e qetë, por do të përpiqeshin gjithsesi për shpërblimin, për mosbërjen e ndonjë mekruhi.

Profeti salallahu alejhi ue selem, ka thënë: *"Vërtet hallalli është i qartë dhe harami është i qartë. Ndërmjet tyre ka gjëra*

të dyshimta, të cilat shumë njerëz nuk i dinë. Kush mbrohet nga gjërat e dyshimta, e ka siguruar veten në pikëpamje të besimit dhe nderit, ndërsa kush ka rënë në gjërat e dyshimta, veçse ka rënë në haram, ngjashëm si bariu, i cili e ruan kopenë rreth një vendi të ndaluar, ku në çast kopeja mund t'i ikë dhe të kullotë në të. Çdo sundues i ka kufijtë e tij, kurse kufijtë e Allahut janë haramet e Tij“.¹

Po të shikojmë pas kësaj që thamë numrin e të sëmurve, që sipas disa statistikave vetëm në Gjermani vdesin mbi 140.000 njerëz në vit nga përdorimi i duhanit dhe numrin e shumtë të sëmundjeve që vijnë si pasojë e përdorimit të duhanit, si dhe të gjithë ato aspekte negative që ka duhani në shoqëri do të mendonim se këshilla mekruh për duhanin është e mirëpritur dhe do të duhej ta zbatonim menjëherë.

Shpesh mund të lexojmë nëpër gazeta, revista e medime të tjera, që cigarja nuk është edhe aq e dëmshme dhe ndikon në qarkullimin e gjakut etj., por duhet të jemi të sigurt, që në rrethana të njohura dhe sipas disa zbulimeve del se shumë kompani, që merren me prodhimin e cigareve, kompanive shëndetësore, të cilat merren me analizën e gjërave të ndryshme shëndetësore, ju dhurojnë miliona vetëm e vetëm, që të shkruajnë një efekt pozitiv, që mund të ketë një cigare. Dhe më e keqja është kur duhanpirësi e gjen veten e tij, d.m.th., identifikohet me shkrimin që duhani përmban vetëm një “të mirë”.

Tymi i duhanit përmban përveç nikotinës më shumë se 4000 elemente kimike. Mbi 40 prej tyre përmbajnë elemente kancerogjene, si p.sh., dyoksid karboni, aromatizues, benzol dhe lidhje të ndryshme metalesh të rënda. Përveç kësaj

“Përmes duhanpirjes pasive ndikohen njerëzit përreth dhe dëmtohen nga tymi i duhanit dhe ata që ndikohen më shumë janë fëmijët, që në këto situata janë tërësisht të pambrojtur, bebet dhe gjithësesi edhe fetuset...”

duhani i një cigareje përmban substanca helmuese, si p.sh., monoksid karboni, karbon azotik, acid të kaltër dhe amoniak. Gjithashtu edhe vetë nikotina është një helm i rrezikshëm për enët e gjakut dhe sistemin nervor. Duhanpirësit mund ta durojnë nikotinën si helm vetëm për shkakun se ata e fusin në trupin e tyre këtë lloj helmi dalëngadalë.

Për shkak të efektit të dëmshëm për shëndetin, konsumi i duhanit mund të llogaritet, si një formë e të dëmtuarit të vetes dhe shkatërrimi i vetes do të na mjaftonte ta emërtojmë si haram. Një ajet në Kuranin Famëmadh thotë: **“Dhe mos e shkatërmoni veten tuaj me duart tuaja.”** Një ajet tjetër thotë: **“... Dhe mos mbytni veten tuaj** (duke mbytur njëri-tjetrin). **Vërtet, Allahu është i mëshirshëm për ju.”** (Kurani: 4: 29)

Profeti salallahu alejhi ue selem, ka thënë në një hadith: **“Kush hidhet nga një kodër (mal) dhe me këtë e vret veten e tij, ai do të hidhet në zjarrin e xhehenemit dhe atje do të qëndrojë përgjithmonë, dhe ai që fut helm në veten e tij, ai do ta mbajë helmin**

¹ Sahihul Buhari nr. 52

në dorën e tij dhe në xhehenem do ta fusë helmin në veten e tij dhe do të qëndrojë atje përgjithmonë, dhe kush e vret veten e tij me një thikë, ai do ta mbajë thikën në dorën e tij dhe në xhehenem do ta fusë thikën e tij në bark dhe do të qëndrojë atje përgjithmonë”².

Përmes duhanpirjes pasive ndikohen njerëzit përreth dhe dëmtohen nga tymi i duhanit dhe ata që ndikohen më shumë janë fëmijët, që në këto situata janë tërësisht të pambrojtur, bebet dhe gjithsesi edhe fetuset.

Profeti salallahu alejhi ue selem, ka thënë: *“Mos u dëmto dhe mos dëmtoni njëri-tjetrin”³.*

Në çastin që pihet duhani është mirë të mendojmë miliona persona nëpër botë që vuajnë nga uria, duke pasur parasysh edhe shpenzimin e të hollave të duhanpirësit, aq më shumë kur edhe burri, edhe gruaja pinë duhan; blerja e një pakete cigare është harxhim i kotë dhe harxhimi i kotë nga një anë mund të llogaritet si haram. Paratë që muslimani do të duhej t'i harxhonte për cigare mund t'i përdorte në vende më të nevojshme.

Po citoj një ajet tjetër kuranor: ***“O bijtë e Ademit, vishuni përshtatshëm kudo dhe kurdo që të faleni! Hani e pini, por mos e teproni, se Ai nuk i do ata që e teprojnë.”***

Po të bëjmë një llogari se në trojet shqiptare jetojnë minimum rreth 4 milionë muslimanë. Ta zëmë sikur çdo i dyti nga këta e konsumon duhanin (2 milion me nga 1 paketë në ditë) dhe ta llogarisim një paketë cigare me 1 €. Vetëm muslimanët shqiptar do të harxhonin 2 milion euro në ditë. Kjo llogari e vogël dhe e thjeshtë na tregon se brenda vitit këta muslimanë do të harxhonin 730 milionë €. Një shumë astronomike kjo, apo jo! Imagjinoni se çfarë

“...Njeriu e ka marrë trupin e tij të mrekullueshëm dhe të pastër nga Allahu si dhuratë dhe duhet ta ketë parasysh që trupi i përket Atij...”

mund të kishin bërë muslimanët shqiptarë me këtë shumë parash dhe e gjitha kjo vetëm për 1 vit.

Më e keqja është se paratë që mblidhen nga konsumi i duhanit ndihmohen dhe mirëmbahen fabrika dhe koncerne të ndryshme, përkrahja e të cilëve është haram më vete. Le të marrim një shembull: Shumë kompani të mëdha për ta ndaluar konkurrencën e tyre në shtetet e botës së tretë tregtojnë edhe produkte të tjera haram, siç është rasti edhe me kompaninë e njohur të duhanit **Philip Morris**, e cila 5 % të fitimit nga duhani i investon dhe tregon birrë (**Miller-Bier**) dhe kjo është një arsye edhe më shumë për një musliman të mos e përdorë duhanin.

Një arsye tjetër shumë e thjeshtë është që duhanpirësit japin një shembull të keq për të tjerët, e sidomos për muslimanët.

Shumë shpesh ndodh që cigarja përdoret për të kaluar stresin, si dhe problemet personale dhe me këtë edhe ngarkesat e ndryshme psikike. Njëlloj si tek alkoolistët, ose forma të tjera të varshmërisë, si droga të ndryshme, varshmëri për lojë, për para, për të konsumuar diçka mundet të ketë në këtë mes një lloj të vogël shirku (t'i bësh Allahut shok, ortak), ngaqë njeriu përdor gjëra të panevojshme, si dhe të dëmshme, në vend që “testin” ta kalojë me durim dhe t'i besojë vetëm Zotit.

² Sahihul Buhari nr. 5778

³ Sahih Ibën Maxhe nr. 1910

Gjithashtu duhanpirësit lëshojnë një aromë jo të këndshme, si për ata që e pinë, ashtu edhe për ata që nuk e pinë duhanin dhe kjo bie në kundërshtim me rregullat dhe dispozitat e pastërtisë:

Profeti salallahu alejhi ue selem, ka thënë: *“Pastërtia është gjysma e besimit”*.⁴

Kur një duhanpirës e le duhanin, ai në fakt ka fituar nefsin e vet, gjë e cila duhet të jetë qëllimi i çdo muslimani.

Përbërësit e një cigare ndikojnë në mënyrë negative në estetikën e një njeriu, e cila njëlloj si shëndeti është një dhuratë e Allahut subhanehu ue teal. Shkencërisht është e vërtetuar, që konsumimi i duhanit ndikon në plakjen e lëkurës, si dhe në shkatërrimin e qelizave vitale të lëkurës dhe kjo ndikon edhe në përshpejtimin e rrudhave të fytyrës.

Tek meshkujt shkenca ka zbuluar, se duhani ndikon në zvogëlimin dhe në përkeqësimin e cilësisë së spermatozoideve, si dhe stimulon impotencën.

Njeriu e ka marrë trupin e tij të mrekullueshëm dhe të pastër nga Allahu si dhuratë dhe duhet ta ketë parasysh që trupi i përket Atij. Duhanpirësit duhet t'i mundojë edhe një problem tjetër, përse ai në fund të jetës së tij e kthen trupin e vet në një formë të fëlliqur dhe të qelbosur.

Pas gjithë këtyre ajeteve, haditheve dhe mendimeve por edhe të ndërgjegjes njerëzore ngremë pyetjen, se përse pirja e duhanit disa njerëzve iu duket si tërheqëse dhe interesante, dhe ka disa të tjerë që e pinë duhanin me ëndje. Për këtë mund të lexojmë ajetin në vazhdim: *“... Atyre djalli ua kishte zbuluar veprat e veta dhe i kishte shmangur nga rruga e drejtë...”* (Kuran 29: 38)

Në një hadith Profeti salallahu alejhi ue selem, ka thënë: *“Zjarri i xhehenemit është i rrethuar me gjëra të dashura ndërsa xheneti është i rrethuar me gjëra të padëshiruara”*.⁵

Disa njerëzve duhanpirja iu duket një veprim inteligjent, interesant, cool, atraktiv, veprim i guximshëm, çlodhës, erotik, ndjenjë e lirisë së vetvetes dhe një siguri e vetvetes dhe shumë gjëra të tjera. Nuk është aspak e habitshme, se pse ndodh kjo gjë. Ka të bëjë edhe me reklamën me të cilën industria e duhanit për çdo vit investon miliona euro dhe me të cilën na paraqet një pamje krejt tjetër, irracionale të cigares dhe të duhanit. Nga ana tjetër industria e duhanit harxhon shuma marramendëse parash për hulumtime të ndryshme me të cilat do të arrijë, që edhe personat që janë në një ambient me duhanpirësit, edhe pse nuk janë duhanpirës, pas një kohe të caktuar do të kenë nevojë për nikotinë.⁶ D.m.th., ndoshta e fillojnë cigaren vetëm e vetëm, sepse gjenden shpesh nëpër ambiente me tym duhani.

Nga këndvështrimi islam djalli e ka mbaruar punën e tij dhe tani e le robin vetëm me maninë e tij (nevojën e tij) dhe pasojat.

Ajeti kuranor në vijim i qartëson këto që thamë: *“... siç bën djalli, i cili i thotë njeriut: “Mos beso”. Por kur ky bëhet jobesimtar, djalli i thotë: “Unë nuk kam të bëj me ty. Në të vërtetë unë i frikësohem Allahut, Zotit të Gjithësisë.”* (Kuran: 59: 16)

Lexueset dhe lexuesit e këtij teksti duhet të krijojnë, në qoftë se kanë nevojë, një karakter të fortë që të kenë mundësi ta largojnë nevojën e nikotinës, ose të mos bëhen pre' e duhanit ose e helmeve të ngjashme. ■

⁴ Sahih Muslim nr. 223

⁵ Sahihul Xhamië nr. 3147

⁶ Shiko revistën gjermane: DER SPIEGEL, Nr. 49/03.12.01, „Händler des Todes“ (tregtarët e vdekjes), fq. 90 f; dhe gjithashtu: DER SPIEGEL, Nr. 24/12.06, „Das Ende der Toleranz“, (Fund i tolerancës). fq. 64.

DIALOGU SI ASPEKT VITAL I THIRRRJES ISLAME

Çasti më i rëndësishëm gjatë dialogut është që gjatë tërë kohës të mbetet i gjallë qëllimi i sinqertë për të arritur tek e vërteta.


MUHAMMED LUTFI SABBAG

I Dërguari i Allahut, salAllahu alejhi ue selem, kërkonte vazhdimisht mundësinë për dialog si mënyrë e dobishme për kumtimin e së vërtetës Islame. Ai e konsideronte dialogun si mjet të rëndësishëm gjatë thirrjes në Islam. Ai, salAllahu alejhi ue selem, e kuptonte mirë dobinë e dialogut, si mënyrë fisnike për të bindur të tjerët në atë që është e drejtë.

Aftësinë për të hapur dialog me të tjerët është një cilësi, të cilën duhet ta kultivojë çdo thirrës në Islam. Në Kuran gjejmë shumë vende në të cilat Allahu na mëson për këtë aftësi. Për shembull, në shumë vende të Kuranit e urdhëron Muhamedin, salAllahu alejhi ue selem, të parashtrojë një numër pyetjesh. Allahu pastaj iu përgjigjet këtyre pyetjeve dhe i zhvillon këto përgjigje në formë të këshillave praktike.

Allahu i Lartësuar thotë: ***“Thuaj: E kujt është toka dhe çdo gjë që ka në të, nëse ju e dini? Ata do të thonë: “E Allahut”. Atëherë thuaju: Përse pra, nuk mendoni? Thuaj: Kush është Zoti i shtatë qiejve dhe Zot i Arshit të madh? Ata do të thonë: Allahu!. Thuaju: E pse nuk frikësoheni pra?”*** (El Muminun, 84-87)

Në Kuran po ashtu hasim në urdhrin e



“Duhet të mundohemi t’i tejkalojmë dhe t’i falim mospërfilljet ndaj personalitetit tonë, që ndoshta do të shfaqen në sjelljen e bashkëbiseduesit...”



Allahut për të polemizuar në mënyrën më të mirë me çifutët dhe të krishterët: *“Ithtarët e librit mos i polemizoni ndryshe (kur i thirrni në fenë tuaj) veçse ashtu si është më së miri, përveç atyre që janë mizorë dhe thuajuni: “Ne i besuam asaj që na u zbrit neve, dhe që u zbriti juve dhe se Zoti ynë dhe Zoti juaj është një, dhe se ne i jemi dorëzuar Atij.”* (El Ankebut, 46)

I Lartësuari thotë: *“Ti (Muhamed) thirr për në rrugën e Zotit tënd me urtësi e këshillë të mirë dhe polemizo me ata (kundërshtarët) me atë mënyrë që është më e mira. Zoti yt është Ai që e di më së miri atë që është larguar nga rruga e Tij dhe Ai di më së miri për të udhëzuarit.”* (En Nahl, 125)

Dialogu, i cili përdoret prej të gjitha palëve të përfshira në të, si mjet për gjurmimin e së vërtetës dhe si mjet për të arritur te kuptimi i ndërsjellë, realisht e ushqen dhe e ngjall dashurinë dhe qetësinë gjatë polemikës. Me siguri që këtu bëhet fjalë për dialogun mes muslimanëve, si prioritet i kohës. Dialogu i cili motivohet vetëm nga dëshira e epërsisë mbi atë me të cilin debatohet nuk është i frytshëm. Triumfi personal nuk duhet të jetë asnjëherë synimi ynë kryesor. Çasti më i rëndësishëm gjatë dialogut është që gjatë tërë kohës të mbetet i gjallë qëllimi i sinqertë për të arritur tek e vërteta.

Imam Shafiu ka thënë: Çdoherë gjatë polemikës shpresoja, se Allahu do ta nxjerrë në pah të vërtetën nga vetë goja e atij me të cilin polemizoja.

Një qasje e tillë është thelbësore për arritjen e synimit që fjala/qëndrimi më i saktë të pranohet nga të gjithë. Kur dialogu nuk zhvillohet për ta shpallur fituesin, por për të arritur tek e vërteta, me lehtësi të madhe pranohet qëndrimi me bazë, si dhe pranohet gabimi i bërë.

Aspekti tjetër i rëndësishëm është të

mos mundohemi ta ngatërrojmë me fjalë atë me të cilin zhvillojmë dialogun. Prej etikës së dialogut është që të mundohemi ta kuptojmë në mënyrën më të mirë qëndrimin e palës kundërshtare, që fjalët e tij t'i analizojmë ashtu si janë shprehur, ku apriori të paramendojmë qëllimin e mirë të bashkëbiseduesit. Një qasje e tillë është më e dobishme, që pala kundërshtare t'i rishqyrtojë qëndrimet e saj, se sa qasja "gjurmoj çdo gabim tëndin".

Qetësia dhe përmbajtja, toni në të cilin nuk ka emocione dhe padurim janë thelbësore për një dialog të mirëfilltë. Promovimi i vetvetes nuk përkon me qasje defensive dhe të përulësh para palës kundërshtare. Duhet të mundohemi t'i tejkalojmë dhe t'i falim mospërfilljet ndaj personalitetit tonë, që ndoshta do të shfaqen në sjelljen e bashkëbiseduesit.

Allahu, subhanehu ue teal, thotë: ***"Nuk është e barabartë e mira dhe e keqja. Prandaj të keqen ktheje në mënyrën më të mirë, se atëherë ai, me të cilin kishit njëfarë armiqësie do të bëhet mik i afërt."*** (El Fussilet, 34)

"Dhe ngutuni (me punë që meritoni) në falje mëkatesh nga Zoti juaj dhe për një xhenet, gjerësia e të cilit është sa gjerësia e qiejve dhe e tokës, i përgatitur për të devotshmit. Ata që japin kur janë shpërlyer edhe kur janë në vështirësi dhe që e frenojnë mllëfin, që ua falin (të keqen) njerëzve, e Allahu i do bamirësit." (Ali Imran, 133-134)

Allahu duke i cituar këshillat e Lukmanit thotë: ***"O djali im, fale namazin, urdhëro për punë të mira, e ndalo nga të këqijat, përballo me durim çdo gjë që të godet, vërtet, këto janë nga çështjet më të pëlqyera."*** (Lukman, 17)

Thirrësi duhet të dallohet me butësi dhe të njihet si njeri i sjellshëm. I Dërguari i Allahut, salAllahu alejhi ue selem,

thoshte: ***"Butësia zbukuron çdo gjë në të cilën gjendet, ndërsa heqja e butësisë prej ndonjë gjëje e shëmton atë."*** (Sahih Muslim nr. 2594)

Në një hadith tjetër ai, salAllahu alejhi ue selem, thotë: ***"Allahu është i butë dhe e do butësinë dhe për butësinë jep atë, që nuk e jep për ashpërsinë."*** (Sahih Muslim nr. 2165)

Gjatë dialogut prej neve kërkohet saktësi dhe kujdes ndaj asaj që themi. Duhet të jemi të drejtë ndaj atij që pajtohet me neve, si dhe ndaj kundërshtarit.

Allahu, subhanehu ue teal, thotë: ***"O ju që besuat! Bëhuni plotësisht të vendosur për hir të Allahut, duke dëshmuar të drejtën, dhe të mos u shtyjë urrejtja ndaj një populli e t'i shmangeni drejtësisë; bëhuni të drejtë, sepse ajo është më afër devotshmërisë. Kini dro Allahun se Allahu di hollësisht për atë që veproni."*** (El Maide, 8)

Pas gjërave që përmendëm, nëse dëshirojmë që fjalët që ne flasim të pranohen, prej neve kërkohet ta vlerësojmë shkallën e tyre të njohjes si dhe mundësinë për t'i kuptuar fjalët që themi. Kujdes të veçantë duhet të kemi ndaj ndjenjave të tyre, si dhe ndaj shtytësve të tyre. Ne duhemi të kemi në konsideratë edhe gjërat që i fyejnë, si dhe pikat ndaj të cilave shfaqin ndjeshmëri specifike.

Nëse i zbatojmë këto sjellje gjatë thirrjes do të kemi mundësi që ta kumtojmë mesazhin tonë në mënyrë të qartë, në mënyrë që të ndikojë në mirëkuptimin, në tolerancën dhe në pranimin e thirrjes tonë prej Allahut. ■

Përktheu: Talha KURTISHI

SQARIMI I SHIRKUT TEK DIJETARËT E MEDHHEBEVE SHAFI, MALIKI DHE HANBELI¹

Ndaj nëse do të ktheheshim disa shekuj mbrapa në kohën e themeluesve të medhhebeve si: Malikut, Shafiut dhe Ahmedit, do të gjejmë shumë pak thënie të tyre rreth këtij fenomeni, sepse feja në atë kohë ishte e pastër

SHKRUAN: BLENDAR HAXHIU

Nuk ka dyshim se shkaku kryesor dhe më i madhi për zbritjen e shpalljeve dhe ardhjen e të dërguarve është adhurimi i Allahut. Një të vetëm e pa shok. Ai që e vështron me vëmendje Kuranin Famëlartë, gjëja e parë që i bie në sy është mbizotërimi i ajeteve që flasin për njësimin e Allahut në adhurim dhe shpërndarjen e tyre në mënyrë harmonike, për ta kujtuar njeriun në mënyrë të vazhdueshme rreth çështjes më të madhe.


Një gjë e tillë vihet re edhe në thirrjen e Profetit, salallahu alejhi ue selem, dhe mësimet e tij, ku ai për trembëdhjetë vjet, në Mekë, e ftoi popullin e tij rreth thelbit të Islamit dhe bazës së tij; rreth fjalës: **La ilahe il-lallah, Muhamed resulullah** (Nuk ka Zot tjetër me meritë veç Allahut dhe se Muhamedi është i dërguar i Tij). Kështu që edhe vëmendja e dijetarëve rreth këtij fakti ka qenë shumë e madhe, sepse mos-sqarimi i këtij themeli për muslimanët do të shkaktonte ndër ta devijime të shumta, humbje dhe mjerim. Ndaj dhe sa herë që kjo

bazë lëkundet tek muslimanët, ata e shtojnë edhe më tepër kujdesin dhe përpjekjen për ta sqaruar esencën e Islamit, e cila njëkohësisht është edhe shkaku i krijimit: **“Thuaj: “Në të vërtetë, namazi im, kurhani im, jeta ime dhe vdekja ime, i përkasin vetëm Allahut, Zotit të botëve. Ai nuk ka asnjë ortak. Kështu jam urdhëruar dhe unë jam i pari që i nënshtrohem Atij”**. En’am, 162-163.

“Me të vërtetë, të është shpallur ty (o Muhamed), si dhe atyre që kanë qenë para teje: “Nëse i shoqëron Allahut diçka tjetër (në adhurim), me siguri që punët e tua do të zhvlerësohen dhe do të jesh ndër të humburit. Prandaj adhuro vetëm Allahun dhe bëhu falënderues!” Ez-Zumer, 65-66.

Ndaj nëse do të ktheheshim disa shekuj mbrapa në kohën e themeluesve të medhhebeve si: Malikut, Shafiut dhe Ahmedit, do të gjejmë shumë pak thënie të tyre rreth këtij fenomeni, sepse feja në atë kohë ishte e pastër dhe njerëzit nuk kishin devijuar në këtë çështje, por pasuesit e tyre më pas kanë shkruar shumë libra, madje voluminoze, sepse tek muslimanët hynë Kulturat Perse e Bizantine, të cilat ndër të

¹ Kemi përmendur në këtë temë përpjekjet e dijetarëve të tre medhhebeve, për arsye se përpjekjet e dijetarëve Hanefi për shpjegimin e shirkut dhe shkaqeve të tij i publikuam në numrin e kaluar, duke i dhënë kështu një rëndësi të veçantë për faktin se trevat shqiptare janë ndjekës të këtij medhhebi.



tjerat e lëkundën edhe këtë bazë të rëndësishme të muslimanëve.

Tashmë le të përmendim disa nga thëniet e këtyre dijetarëve rreth shirkut, llojeve dhe mënyrave të tij.

Realiteti i shirkut:

Ali Suejd Shafiu² -Allahu e mëshiroftë-, ka thënë: “Dije, Allahu më ruajt mua dhe ty

nga shirku, mohimi dhe humbja dhe na dhuroftë sukses të veprojmë ato gjëra, të cilat Ai i do dhe kënaqet, qofshin fjalë apo vepra, se shirku (idhujtaria) është e kundërta e teuhidit³ dhe ato nuk mund të bashkohen, sikurse dhe mohimi është e kundërta e besimit dhe se ato nuk mund të pajtohen.⁴

Ndërsa **Ahmed b. Haxher Al-Butami** -

² Alij b. Muhamed Seid b. Abdulla b. Hasen Es-Suejdi ka vdekur më 1822 në Bagdad.

³ Veçimi i Allahut në adhurim dhe të gjitha ato gjëra që janë veçori, merita dhe të drejta të Tij.

⁴ El-Akd Eth-Themijn, 18.

“Shirk është vendosja e krijesës në pozitat e Krijuesit, duke e adhuruar apo lartësuar, pra, ai është vendosje e gjërave jo në vendin e duhur” ...”

Allahu e mëshiroftë- ka thënë: Shirku është dy llojesh: i madh dhe i vogël, kush shpëton prej tyre do të hyjë në Xhenet e kush vdes duke bërë shirk të madh do të hyjë në Zjarr... Robi do të gjykohej për shirkun e tij, qoftë i madh apo i vogël... Shirk i madh është: rënia sexhde për dikë, zotimi për dikë tjetër në vend të Allahut etj., ndërsa shirkun i vogël është: syfaqësia e lehtë, betimi për dikë në vend të Allahut, nëse me këtë betim nuk kihet për qëllim madhërimi i personit, sepse në të kundërtën është i madh⁵.

Imam **Ibën Rexheb el-Hanbeli** -Allahu e mëshiroftë- e ka përkufizuar kështu shirkun: “Shirk është vendosja e krijesës në pozitat e Krijuesit, duke e adhuruar apo lartësuar, pra, ai është vendosje e gjërave jo në vendin e duhur”⁶.

Ndërsa myftiu i hanbelive në Mekë në kohën e tij; **Ebu Bekër b. Muhamed Arif Haukir** -Allahu e mëshiroftë- ka thënë: “Shirku është përngjasimi i krijesës me Krijuesin në cilësitë hyjnore me të cilat është veçuar Allahu i Madhëruar; ose me një

shprehje tjetër mund të thuash: Besimi se dikush tjetër veç Allahut ndikon mbi atë që i ka dhuruar Allahu, apo se dikush ka pozitë më të madhe se kufijtë e krijesave.”

Sqarimi i llojeve të shirkut dhe rrugëve të tij

Ka ardhur nga imamët e medhhebeve dhe ndjekësit e tyre sqarimi rreth veprave të shirkut dhe rrugët që të çojnë tek ai. Ata na kanë ndaluar nga këto vepra, si: ndërtimi mbi varre, lyerja dhe zbukurimi i tyre, marrja e tyre si vend falje apo lutje, puthja apo parfumimi i tyre, si dhe vendosja e dritave apo tendave tek ato, tavafi (rrotullimi) rreth tyre, marrja e dheut të tyre duke menduar se të shëron apo të sjell mbarësi dhe udhëtimi për tek ato.

Po ashtu ata kanë sqaruar se lutja e dikujt tjetër pos Allahut, kërkimi i ndihmës e zotimi, betimi dhe mbështetja, sexhdja dhe kurhani, nëse bëhen për të tjerë në vend të Tij, atëherë njeriu ka rënë në shirk. Prej shirkut është edhe besimi, se dikush tjetër në vend të Allahut e di të fshehtë, apo se dikush tjetër pos Tij mund të mbikëqyr universin apo të veproj në të.

Imam Neveviu -Allahu e mëshiroftë- ka thënë: “Është e ndaluar lyerja e varreve, ndërtimi dhe shkrimet në to.”

Ndërsa **Imam Bagaui** -Allahu e mëshiroftë- ka thënë: “Nuk lejohet vendosja e tendave mbi varre, sepse Omeri pa një varr të mbuluar me tendë dhe urdhëroi ta hiqnin atë e më pas tha: Lëreni t'i bëjë hije (ta mbulojë) puna e tij”⁷.

Haxhaui⁸ -Allahu e mëshiroftë-, në librin e tij **Ikna** ka thënë: “Kush vendos mes tij dhe

⁵ Një fenomen i tillë është i përhapur shumë në viset shqiptare, ku dëgjon betime nga më të ndryshmet, si: për kokë të babës, apo të çunit, për nder, për kishë të Laçit, për Baba Tomor, Ja Abaz Ali etj., të gjitha këto janë shirk (idhujtari), madje dy të fundit janë shirk i madh, sepse zakonisht ata që i bëjnë këto betime kanë si qëllim madhërimin e tyre.

⁶ Enciklopedija e dijes dhe e urtësisë v. 2 fq. 181.

⁷ El-Mexhmu 5/266.

⁸ Sherefudijn Musa b. Ahmed Ebi Nexha El-Haxhaui el-Makdisi ka vdekur më 1978 h.

Allahut ndërmjetës, duke u mbështetur tek ata, apo duke iu lutur atyre, ai ka mohuar (ka bërë kufër) në mënyrë unanime, sepse kjo është vepër e idhujtarëve”.⁹

Po ashtu imam **Ebul Uefa Alij b. Akijl**¹⁰ - Allahu e mëshiroftë- ka thënë: “Ai që i madhëron varret dhe i thërret të vdekurit (kërkon prej tyre), që t’i kryejnë nevojat, ai ka mohuar”.

Imam Ibën Rexhebi -Allahu e mëshiroftë- ka thënë: “Fjala la ilahe il-Allah (nuk ka Zot tjetër me meritë veç Allahut), që thotë njeriu, nënkupton atë se nuk ka të adhurar tjetër veç Allahut dhe Zoti është Ai, të cilit i bindesh dhe nuk e kundërshton, duke iu frikësuar e duke e madhëruar, duke e dashur e shpresuar, duke u mbështetur tek Ai e duke i kërkuar, dhe të gjitha këto nuk i takojnë askujt tjetër veç Allahut. Ndaj çdokush që i shoqëron ndonjë krijesë në këto vepra (duke ia drejtuar atij këto), të cilat janë veçori të Allahut, atëherë ai e ka shpërfillur sinqeritetin e tij ndaj fjalës “La ilahe il-Allah” e ka cunuar njësimin e tij ndaj Allahut dhe ka rënë në adhurimin e krijesave, aq sa ka vepruar për ta nga këto vepra”.¹¹

Ahmed b. Haxher Al-Butami -Allahu e mëshiroftë- ka thënë: “Kush bën ruku e sexhde për dikë tjetër veç Allahut, qoftë të gjallë apo të vdekur, ose premton në emër të dikujt tjetër, ai ka bërë shirk. P.sh.: të premtoj në emër të ndonjë të vdekuri (për teqenë, tyrben, për varret e ndryshme, ose të therë kurban për hir të tyre, të vijë

përqark varreve të tyre etj). Po ashtu kush kërkon prej tjetërkujt atë që mund të ta japë vetëm Allahu, si fjala vjen: kërkon shërimin e vetes apo të ndonjë personi tjetër, të kërkojë t’i dhurojë fëmijë, t’i jap rrizk e të ngjashme me to, ka rënë në idhujtari (shirk) dhe Allahu për idhujtarinë ka thënë: **“Vërtet, Allahu nuk fal që të adhurohet dikush apo diçka tjetër veç Atij, por gjynahet e tjera më të vogla ia fal kujt të dojë. Kushdo që i bën shok Allahut (në adhurim), ka bërë gjynah të tmerrshëm”**. En-Nisa, 48

Lexues i nderuar!

Kjo që kemi paraqitur këtu nuk është gjë tjetër veçse një grimcë e vogël nga përpjekja dhe kujdesi që kanë treguar dijetarët rreth fenomenit dhe veprës më të rrezikshme Shirkut. Jemi përpjekur të mos prekim thënie e dijetarëve, të cilët përfliten nga një pjesë e mirë e njerëzve,¹² dhe kjo është bërë me qëllim, në mënyrë që të mos zgjateshim dhe që ata të kuptojnë e mësojnë, se nuk janë ata të vetmit që kanë folur për këto çështje.

Lutja jonë është që Allahu të na bëjë ndjekës së rrugës së pastër, të na ruajë nga rënia në shirk dhe të na dhurojë punë të mira. ■

⁹ Ikna litalib El-Intifa 4/297.

¹⁰ Ebu El-Uefa Alij bin Akijl Bagdadiu dijetar hanbeli që ka vdekur më 513 h.

¹¹ Kelimetul Ihlas 18-19.

¹² Bëhet fjalë për dijetarë si: Ibën Tejmije, Ibën Kajimi, Muhamed b. Abduluehabi etj.; në mënyrë që lexuesi ta kuptojë, se këta dijetarë nuk janë të vetmit, që e kanë kuruar këtë fenomen, porse janë vetëm disa hallka në zinxhirin e gjatë e të pafund të dijetarëve, të cilët janë përpjekur për t’ua sqaruar njerëzve fenë e tyre. Ajo që bie në sy tek këta dijetarë është, se kanë shkruar pak më shumë se të tjerët, për vetë faktin se njerëzit në kohën e tyre ishin dhënë pas idhujtarisë, dhe më e keqja është se disa fenomene të saj i konsideronin si pjesë e Fesë Islame.



TALAKU-DIVORCI

E natyrshme është që njerëzit të ndryshojnë, saqë mund të ftohen nga njëri-tjetri, pastaj të ndodhin mospajtime, të cilat shpeshherë edhe nuk mund të zgjidhen. E njëjta gjë mund të ndodhë edhe mes bashkëshortëve dhe të arrijë deri në atë shkallë, saqë e vetmja gjë e mirë që mund t'u ndodhë atyre është ndarja – talaku

SHKRUAN: OMER BERISHA

Në vitin 2006, në Tiranë, vetëm brenda 9-mujorit të parë janë depozituar 866-kërkesa për divorc, nga të cilat kanë arritur të gjykohen dhe kanë përfunduar me

ndarje 605-çifte.¹ Në vitin 2007, në Kosovë gjithsej janë shkurorëzuar 1558 çifte.² Ndërsa në Maqedoni në vitin 2007 ndodhën gjithsej 1339 ndarje çiftesh.³

Shifrat e këtilla na tregojnë se divorci në trojet tona ka marrë përmasa të mëdha dhe kjo të bën të mërzitësh. Ai ndodh për shkaqe

¹ Gazeta Shekulli nr. 3118 (29 Nëntor 2006)

² Enti i statistikës së Kosovës (www.ks-gov.net/esk)

³ Enti shtetëror i statistikës në Maqedoni (www.stat.gov.mk)

të ndryshme, herë të arsyeshme e shpeshherë edhe për shkaqe banale. Sidoqoftë, ne duhet ta pranojmë këtë realitet dhe të flasim për të. Pasi Islami është fe e jetës dhe dispozitat e tij përfshijnë çdo anë të saj, atëherë le të shohim ligjet e kësaj feje për këtë dukuri.

Divorci në Islam, shtjellohet me imtësi në librat e shkencës së **Fikhut** (Jurisprudencës Islame), ndërsa termi që përdoret për këtë është fjala “**Talak** – طلاق”.

”, që gjuhësisht nënkupton zgjidhjen apo lirim nga një lidhje. Ndërsa në terminologji përkufizohet: “Mbarimi i kontratës së kurorëzimit, menjëherë apo më vonë, me fjalë që aludojnë në të”.

Talaku është i ligjësuar me Kuran, Sunet dhe pajtim të njëzëshëm të muslimanëve. Allahu, subhanehu ue teala, ka thënë: **“E drejta e talakut është dy herë, pra, ose mbajini me njerëzi ose lëshojini me bamirësi”**. (Bekare 229).

Urtësia e ligjësimi të talakut është se ai është një rregull realist për njerëzimin dhe kjo numërohet nga mirësitë e Sheriatit Islam, i cili është realist dhe nuk e anashkalon interesin e njerëzve, pavarësisht kohës dhe vendit. E natyrshme është që njerëzit të ndryshojnë, saqë mund të ftohen nga njëri-tjetri, pastaj të ndodhin mospajtime, të cilat shpeshherë edhe nuk mund të zgjidhen. E njëjta gjë mund të ndodhë edhe mes bashkëshortëve dhe të arrijë deri në atë shkallë, saqë e vetmja gjë e mirë që mund t’u ndodhë atyre është ndarja – talaku, harxhohen të gjitha mirësitë e martesës dhe fillon një jetë e rëndë për bashkëshortët, e cila ndoshta ndikon edhe në vështirësimin e çdo gjëje. Gjithashtu, steriliteti nga ana e burrit apo gruas mund të bëhet shkak që gruaja apo burri të kërkojë ndarjen, sepse ajo/ai gjithmonë ëndërron të ketë fëmijë.

Në dorë të kujt është talaku

Talaku është legjitim vetëm nëse atë e bën një burrë i mençur, me zgjedhje të lirë dhe e kupton se ç’është duke thënë. Është e drejtë e burrit për disa shkaqe:

sepse udhëheqja e familjes është në dorë të burrit,

talaku është çështje e rrezikshme, sepse me të prishet një lidhje martesore, e cila në thelb është kurorëzuar për të jetuar deri në fund të jetës. Prandaj, nuk lejohet të shpejtohet, ndërsa realiteti dëshmon se burri duron dhe mund ta përmbajë veten më shumë sesa gruaja. Kjo nuk do të thotë se ndonjëra prej grave nuk është më e përmbajtur dhe më e plotë sesa burrat, por është dukuri më e rrallë, ndërsa dispozitat ndërtohen mbi dukuritë më të shpeshta. Disa prej grave, madje janë shprehur: Sikur talaku të jetë në duart tona, nuk do të mbijetonte asnjë martesë, sepse shumica jonë kur zemërohem, u themi burrave: “Çomë te babai”.

Talaku për burrin ka edhe pasoja materiale dhe kjo ndikon që ai të mos shpejtojë për ta lëshuar gruan e tij.

Dispozita e talakut

Ajo ndryshon varësisht nga gjendja e burrit:

Është mubah (i lejuar) në rast nevojë. Nëse një burrë nuk mundet të durojë sjelljen e keqe të gruas së tij, i lejohet ta lëshojë atë. Edhe pse Allahu na porositi për durim: **“Çoni jetë të mirë me to, por nëse i urreni duroni, sepse ndodh që Allahu të japë shumë të mira në diçka që ju urreni”**. (Nisa 19). Por ai që nuk mund të durojë, e ka të lejuar talakun.

Është mekruh (e urryer) kur bëhet pa asnjë nevojë. Pra, nëse gjendja në familje është krejt në rregull është e urryer prishja e atij kurorëzimi.

“Ajo grua që kërkon talakun nga burri i saj, pa ndonjë arsye, i ndalohej ta shijojë erën e xhenetit”..”

Është **mustehab** (e pëlqyer) në rast se gruaja dëmtohet. Nëse burri vëren se gruaja e tij vazhdimisht dëmtohet, është e pëlqyer që ta lëshojë edhe pse e do. P.sh., nëse një grua pasi martohet sëmuret nga nervat, humb disponimin, – siç mund të ndodhë shpesh – saqë lodhet, qan, mërzhitet dhe nuk bën asnjë përmirësim, ndërsa ky e do, i themi: Parapëlqehet ta lëshosh këtë grua, normalisht pasi të marrësh edhe mendimin e saj, sepse kështu do t’i bësh mirë duke mos vazhduar ajo të dëmtohet. Ndërsa ajo që bëjnë disa zullumqarë, kur thonë ‘nuk e lëshoj derisa të më paguajë kaq dhe aq’ është një zullum që mund ta bëjnë vetëm njerëzit e paskrupullt.

Është **farz**, në rast se bën betimin e “keq”. Betimi i “keq” siç e quajta kushtimisht, është kur burri betohet, se nuk do të ketë kontakte seksuale me gruan e tij katër muaj e më tepër. Këtë e mësojmë nga ajetet: **“Ata që betohen se nuk do të kenë kontakt (seksual) me gratë e tyre, afati i pritjes për ta është katër muaj. Por nëse kthehen (nga betimi) s’ka dyshim se Allahu fal dhe mëshiron. E nëse kanë ndërmend talakun, le ta dinë se Allahu dëgjon dhe di”**. (Bekare 226-227). Pra, menjëherë pas atij betimi, gruaja e tij konsiderohet e lëshuar.

Është **haram** në rast se talaku bëhet me bidat. E kanë quajtur talak me bidat, sepse bëhet në atë mënyrë, që kundërshton

urdhrat e Allahut, ndërsa mënyra e lejuar quhet talak me sunet. Talaku me bidat bëhet, nëse kundërshtimi bëhet në numrin e talakëve ose në kohë të ndaluar për talak.

- talak me bidat në kohë, numërohet nëse talaku bëhet kur gruaja është me menstruacione, ose është e pastër, por ai ka fjetur me të gjatë kësaj periudhe.

- talak me bidat në numrin e talakëve, numërohet nëse burri e bën talakun më shumë se një herë. Në këtë formë: ‘Ti je e bërë talak dy herë’ ose ‘Ti je e bërë talak, ti je e bërë talak, ti je e bërë talak’, sepse sipas sunetit është që vetëm një herë t’i thotë se është e bërë talak.

Por, a është legjitim ky lloj talaku (me bidat në numrin e talakëve)? Shumica e dijetarëve thonë se ai lloj talaku është legjitim, por mendimi më i vërtetë është se ai nuk vlen. Pra, nëse një burrë i thotë gruas: ‘Ti je e bërë talak, ti je e bërë talak’, sipas mendimit më të vërtetë ky llogaritet një talak dhe jo dy, sepse e dyta është bidat dhe nuk lejohet ta miratojmë bidatin. Po të thoshim se ndodhën dy divorce, kjo do të ishte miratim i bidatit, gjë të cilën e kemi të ndaluar. Gjithashtu, hadithi: *“Kush bën një vepër që nuk pajtohet me tonat, ajo është e refuzuar”*⁴, na jep të kuptojmë se talaku i dytë nuk vlen, sepse ai është bidat, ndërsa bidati nuk vlen. Ky është mendimi im. Këtë mendim e ndan edhe Shejhul Islam Ibën Tejmie dhe hoxha im Abdurrahman b. Sadi. Ajo që thamë për gruan në menstruacione vlen edhe për gruan lehonë.⁵

Duhet ditur se në thelb talaku është i ndaluar, por Allahu nga mëshira e Tij e lejoji, sepse njerëzit kanë nevojë për të ndonjëherë. Allahu e urren talakun, ndërsa ata që e duan dhe e urdhërojnë janë shejtanët dhe magjistarët, siç na rrëfen

⁴ Muslimi nr. 1718

⁵ Dispozitat e talakut që po përmenden këtu i kam shkurtuar nga libri “Sherhul mumtië ala Zail musteknië” (13/8-14) i Muhamed b. Salih el-Uthejmin.

Allahu: “...prej atyre dyve mësojnë si të ndajnë njeriun nga gruaja e tij...” (Bekare 102), po ashtu Resulullahu, salAllahu alejhi ue selem, thotë: “Iblisi vendos fronin e tij mbi ujë dhe lëshon ushtarët e tij, më i afërti me të është ai që ka bërë çrregullimin më të madh. Njëri vjen dhe krenohet: ‘Nuk iu ndava njërit derisa piu alkool’. Ky i përgjigjet: ‘Së shpejti do të pendohet’. Ndërsa tjetri vjen duke u krenuar: ‘Nuk u largova nga njëri derisa arrita ta ndaj nga gruaja e tij’. Këtë e afron dhe i thotë: ‘Ti, dhe vetëm ti’.”⁶ Po ashtu Resulullahu, salAllahu alejhi ue selem, ka thënë: “Ajo grua që kërkon talakun nga burri i saj, pa ndonjë arsye, i ndalohet ta shijojë erën e xhenetit”⁷

Gjërat me të cilat bëhet talaku

Talaku bëhet me çdo gjë që aludon përfundimin e një lidhje martesore, pa marrë parasysh a bëhet me fjalë, me shkrim, me shenja apo duke autorizuar dikë.

1. Talaku me fjalë

Mund të bëhet me **fjalë të qarta** e të drejtpërdrejta, të cilat në momentin e shqiptimit kanë kuptimin e talakut. Imam Shafiu ka thënë: “Fjalët e qarta për talakun janë: talak (divorc), ndarje (firak) dhe lëshim (sirah), të cilat janë shprehur në Kuran”.⁸ Pra, në cilëndo formë gramatikore që përdoren këto fjalë, rezultati është i njëjtë, si p.sh., ti je e bërë talak, të kam bërë talak, je e lëshuar, të kam lëshuar, unë jam i ndarë nga ti, ti je e ndarë nga unë etj., të gjitha këto numërohen si fjalë të qarta për të bërë divorc gruan. Por gjithashtu bëhet edhe

me **shprehje metonimike**, të cilat kanë edhe kuptim tjetër përveç talakut. Si p.sh.: Je e lirë, s’ke burrë, ec, shko te babai yt, dil, s’je grua për mua, kërko burrë më të mirë, etj.

Dallimi mes fjalëve të qarta dhe shprehjeve metonimike qëndron në atë se: nëse burri i thotë fjalët e qarta, atëherë divorci llogaritet i vlefshëm edhe sikur burri të mos e kishte pasur si qëllim atë, pa marrë parasysh a ka qenë serioz apo ka bërë shaka. Pejgamberi, salallahu alejhi ue selem, ka thënë: “Në tri gjëra serioziteti është seriozitet, por edhe shakaja është seriozitet: martesa, divorci dhe kthimi (i gruas pas divorcit)”⁹

Kurse, me shprehjet metonimike divorci nuk është i vlefshëm, përveç nëse burri e ka thënë atë me qëllim të divorcit.¹⁰

2. Talaku me shkrim

Nëse një burrë ia drejton një letër me shkrim gruas së tij dhe i thotë se e ka bërë talak, talaku është i vlefshëm dhe ajo grua konsiderohet e lëshuar. Dijetarët kanë kushtëzuar dy gjëra:

a. ajo letër të jetë e qartë, të lexohet mirë dhe

b. të jetë e adresuar deri tek ajo grua, me fjalët: ‘O filane, ti je e bërë talak’.

Por, nëse ky shkrim bëhet me “sms” apo “e-mail” krahas këtyre dy kushteve duhet shtuar si kusht edhe verifikimin e identitetit të atij që e ka postuar.

3. Talaku duke bërë me shenjë

Kjo vlen vetëm për memecin. Pra, nëse ai jep një shenjë, që sigurisht nënkupton talakun, talaku është i vlefshëm.

⁶ Sahih Muslim nr. 2813

⁷ Mexhmuul Fetava 33/81 (botimi i ri 17/48-49) me përshtatje të lehtë.

⁸ Fikhus Sunne 2/171

⁹ Ebu Davudi nr. 2194; Ibën Maxhe nr. 2039. Albani e ka vlerësuar hasen në Sahih Ibën Maxhe nr. 1671

¹⁰ Shpjegim i shkurtër i Legjislaturës Islame fq. 376-377

4. Talaku me autorizim

Talaku konsiderohet i vlefshëm, nëse një burrë autorizon një person, që e lajmëron gruan e të parit, se ajo është e lëshuar.

Talaku me kushtëzime

Shumica e dijetarëve ndahen në mendimin, se talaku me kushtëzime është i vlefshëm, duke u bazuar në hadithin: *“Muslimanët iu përmbahen kushteve, përveç ndonjë kushti që lejon haramin apo ndalon hallallin”*¹¹.

Talaku me kushtëzime është tre llojesh:

Një: Të jetë kushtëzim në tërësi dhe asgjë tjetër, në atë rast talaku ndodh. Si p.sh., nëse një burrë i thotë të shoqes: ‘Kur të perëndojë dielli, ti je e bërë talak’. Atëherë posa të perëndojë dielli, ajo grua është e lëshuar, sepse ashtu ishte kushtëzimi.

Dy: Të jetë betim në tërësi dhe asgjë tjetër, në atë rast talaku nuk ndodh, por ky detyrohet të shpaguajë betimin e parealizuar. Si p.sh., nëse një burrë i thotë dikujt: ‘Nëse i flas Bashkimit, gruaja ime është e lëshuar’, ndërsa ka si qëllim se nuk do t’i flasë më Bashkimit. Pra, kjo fjalë e tij është thjesht një betim, se nuk do t’i flasë Bashkimit dhe kjo s’ka të bëjë aspak me lëshimin e gruas së tij. Në këtë rast, talaku nuk ka ndodhur, ndërsa ky duhet të shpaguajë për betimin e parealizuar.¹²

Tre: Të jetë e mundshme me qenë kushtëzim në tërësi apo betim në tërësi, varësisht nga nijeti i njeriut. Si p.sh., nëse një burrë i thotë të shoqes: ‘Nëse del nga shtëpia pa lejen time, ti je e lëshuar’. Ka mundësi që nijeti i burrit ishte thjesht

kushtëzimi që d.m.th., nëse ajo del pa lejen e tij, ky nuk dëshiron ta mbajë më tepër atë grua dhe talaku ndodh, pra, ai kishte si qëllim talakun.

Por, nëse qëllimi i tij me ato fjalë nuk është talaku, madje edhe nëse del ajo, ky sërish dëshiron ta mbajë atë grua dhe nuk dëshiron ta shkurorëzojë, ndërsa kushtëzimin ia ka thënë me qëllim që ajo të mos dalë asnjëherë pa leje, por prapë se prapë ajo doli, themi se talaku nuk ka ndodhur, sepse nuk ishte ky qëllimi i burrit. Sidoqoftë fjala e tij konsiderohet si betim dhe ky duhet të shpaguajë për betimin e parealizuar.

Një mesele: Nëse një burrë bën kushtëzimin dhe ka si qëllim talakun, a ka të drejtë ta tërheq kushtëzimin ose jo?

Shumica e dijetarëve thonë se nuk ka të drejtë ta tërheqë kushtëzimin, sepse ai është shprehur dhe ky detyrohet ta çojë deri në fund.

Ndërsa Shejhul Islam Ibën Tejmie thotë: Ky kushtëzim është në dorë të tij dhe nëse e tërheq nuk ka përgjegjësi.¹³

Allahu e di më së miri. ■

(Vazhdon me nëntitujt: Pritja e gruas pas talakut, Kthimi i gruas, Mbikëqyrja e gruas pas talakut, Kujt i takojnë fëmijët dhe kush përkujdeset materialisht për ta...)

■
¹¹ Sahihul Xhamië nr. 6714

¹² Shpagimi i betimit të parealizuar është që të ushqejë dhjetë të varfër ose t’u japë veshmbathje, e nëse nuk ka mundësi, atëherë duhet të agjërojë tre ditë.

¹³ Shpjegimet rreth talakut me kushtëzime i kam shkurtuar nga libri “Sherhul Mumtië ala Zail Musteknië” (13/124-126).

VEPRIMI

Fatkeqësia më e madhe e njeriut është dituria e shumë dhe mosvënia e saj në praktikë. Njeriu i ngritur është ai që flet pak e vepron shumë. Urtësi është të dish se çfarë duhet bërë, mjeshtri është të dish se si duhet bërë, ndërsa sukses është të veprosh.


SHKRUAN: AGRON TERZIQI

Mund të kesh entuziazëm, energji, njohuri dhe potencial të nevojshëm intelektual për të pasur sukses... mirëpo, nëse nuk i vendos në dispozicion të veprimit dhe të zbatimit, atëherë të gjitha këto mundësi dhe aftësi do të jenë të pavlera. Prandaj, lidhur me këtë deklarojmë se: “Nëse njohuritë nuk vihen në veprim, atëherë ato mund të të çojnë në dështim

dhe zhgënjim.”

A njeh ndonjë person për të cilin mendon se e di saktësisht se çfarë duhet të veprojë, që ta ndryshojë jetën dhe po ashtu e di se kur duhet të veprojë, mirëpo nuk ndërmerr asgjë...? A ke hasur në ndonjë individ që ka arritur shkallët më të larta të shkollimit dhe zotëron çdo gjë që do t'i duhej për të bërë një jetë më të mirë, mirëpo qëndron duarkryq duke mos bërë asgjë?

Në të kundërtën, a të ka rastisur të takosh ndonjë njeri, i cili ka nivel mesatar



shkollimi, bile nganjëherë edhe pa asnjë diplomë, por shumë i suksesshëm në jetë?... Dallimi ekziston tek një fjalë e vetme "Veprimi".

Fatkeqësia më e madhe e njeriut është dituria e shumë dhe mosvënia e saj në praktikë. Njeriu i ngritur është ai që flet pak e vepron shumë. Urtësi është të dish se çfarë duhet bërë, mjeshtri është të dish se si duhet bërë, ndërsa sukses është të veprosh.

Universiteti Jeil në Shtetet e Bashkuara të Amerikës ka bërë një studim dhe ka dalë me këto rezultate: neve na mbeten në kujtesë nga gjërat që i dëgjojmë vetëm 10%, ato që i kemi parë 25%, ndërsa gjërat që i kemi vepruar 90%.

Nëse dikush pyet si të bëhem i suksesshëm? Atij i themi: "Nëse je i bindur në saktësinë e planeve të tua, të cilat i ke në mendje dhe nxiton për t'i realizuar ato, me lejen e Zotit Fuqiplotë, do të arrish sukses të paimagjinuar më parë."

Që njeriu të shpresojë dhe të imagjinojë është diçka pozitive për të, por nëse ai fantazon, ai patjetër duhet të fillojë që të veprojë për ta realizuar atë fantazi, ngase shpresa dhe dija janë gjëra të mira, mirëpo si të tilla janë të pamjaftueshme. Për fat të keq shumica e njerëzve bëjnë një jetë larg potencialeve dhe mundësive të tyre reale, si: kryerja e punëve, të cilat nuk i duan dhe nuk ndjejnë kurrfarë kënaqësie, lidhjet me njerëz, të cilët u sjellin vetëm stres, kështu që në vend që të përpiqen të gjejnë zgjidhje

për problemet e tyre ata gjithmonë i gjejnë duke u ankuar.

Ekzistojnë vetëm dy shkaqe që i pengojnë njerëzit që aftësitë e tyre t'i vënë në veprim e ato janë: "Frika dhe zvarritja."

Frika është armiku kryesor i njeriut dhe barriera e parë që hasin njerëzit në realizimin e synimeve të tyre.

Ekzistojnë katër lloje të frikës:

- Frika nga dështimi

Personi që ka pasur përvoja të dështuara, ka shumë të ngjarë që në të ardhmen të ngurrojë që të provojë prapë dhe kjo i vjen pikërisht nga frika për mosesukses. Ka mundësi që ky person qysh në moshë të re ta ketë programuar veten në atë formë që në të ardhmen të mos bëj asnjë aventurë dhe hap tjetër, meqë gjatë tërë jetës së tij ai ka parë babanë duke kryer për çdo ditë të njëjtën veprimtari, e ai e ka këshilluar që ta marrë atë si model, në mënyrë që të mos i ekspozohet asnjëherë dështimit.

- Frika nga refuzimi

Njerëzit ngurrojnë që të bëjnë ndryshime në jetën e tyre nga frika se mos po i refuzojnë të tjerët.

- Frika nga e panjohura

Frika prej gjërave të panjohura shpesh na pengon që të ndërmarrim çfarëdo veprimi.

“... Njerëzit që kanë pësuar dështime më të mëdha gjatë karrierës së tyre dhe kanë vazhduar gjer në sukses, sot njihen me emra si: shkencëtarë, zbulues, mjeshtër, shpikës, njerëz me eksperiencë të madhe etj...”

- Frika nga suksesi

Mbase njerëzit çuditen se si ka mundësi, që dikush të ketë frikë nga arritja e suksesit, por të jesh i bindur se ka shumë të atillë, që besojnë se parimi i suksesit është dhimbje, mashtrim, vetmi, xheloz, dallavere... etj. Personi që frikësohet prej suksesit nuk ka besim në vetvete dhe është njeri pa sedër. Ka të atillë që nuk mund ta paramendojnë veten të pasur, e nëse u ndodh që të përfitojnë më tepër se zakonisht, shpejtojnë t'i harxhojnë ato menjëherë. Prandaj frika prej suksesit ka mundësi që t'i pengojë njerëzit t'i realizojnë aspiratat e tyre.

Zvarritja.

Shumica prej nesh detyrimet që duhen kryer sot i shtyjnë për nesër, për javën e ardhshme e kështu me radhë. Nëse ke ndonjë synim për të cilin shpreson ta realizosh, ndërsa në të njëjtën kohë ndjen se diçka është duke të penguar për ta filluar veprimin, kërkoje shkaku real të tërë kësaj dhe pyete veten:

- Çfarë është ajo që është duke më penguar për të filluar punën?
- Cila është gjëja më e keqe që ka mundësi të më ndodhë, nëse unë me të vërtetë veproj?
- Cila është gjëja më e mirë që mund të më ndodhë, nëse unë filloj së vepruari?

Mundohu t'i kujtosh rastet në të cilat je ballafaquar me vështirësi gjatë jetës tënde dhe ke pasur mundësi t'i tejkalosh ato. Dijeni se në jetë nuk ka dështime, por vetëm përvoja. Njerëzit që kanë pësuar dështime më të mëdha gjatë karrierës së tyre dhe kanë vazhduar gjer në sukses, sot njihen me emra si: shkencëtarë, zbulues, mjeshtër, shpikës, njerëz me eksperiencë të madhe etj. Mos u dëshpëro nga dështimet, sepse më shumë duhet të merakosesh për mundësitë dhe shanset që të humbasin pa u munduar

që t'i provosh ato. Një fjalë e urtë popullore thotë: "Nëse rrëzohesh shtatë herë, ngrihu për të tetën." Vendimi i duhur vjen zakonisht pas një përvoje nga vendimet e gabuara.

Nuk është e rëndësishme sa herë nuk ke pasur sukses në të kaluarën, apo sa herë ke dështuar, e rëndësishme është që tani të veprosh dhe të përfitosh nga humbjet, të cilat i ke pësuar në të kaluarën. E kaluara është pasuri e vlefshme, që përmban urtësi, forcë, mjeshtri dhe përvojë. Fillo të veprosh që sot pa marrë parasysh se çfarë flasin njerëzit për ty, mos ua vej veshin fjalëve të tyre, përqendrohu vetëm në realizimin e ëndrrave të tua. Ti duhet ta akumulosh entuziazmin tënd dhe të fillosh veprimin, pasi për të arritur aty ku synon duhet të bësh plane dhe projekte, ndërsa shumica e njerëzve kanë dështuar, sepse nuk kanë pasur plane të qarta për realizimin e synimeve të tyre.

Askush nuk mund të ketë sukses, nëse nuk fillon kurrë, mos e bëj çfarëdo pengese si arsye për të mos-vepruar, sepse pas furtunës vjen qetësia.

Tani po ua paraqes projektin:

- Shkruaj tri synime, të cilat synon t'i arrish.
- Vendos një plan të studiuar mirë për secilin.
- Krijë në vetvete ndjenjën e shpejtësisë dhe të përgjegjësisë.
- Nis menjëherë veprimin.
- Përkujtoje veten çdo ditë, që je në gjendje t'i realizosh objektivat e tua.
- Sillu sikur me të vërtetë i ke arritur ato dhe
- Mos e krahaso veten me askënd, por krahasojë veten se si ke qenë në të kaluarën dhe çfarë mund të jesh në të ardhmen. ■

GRUAJA NDËRTON JETËN

Nëse shpalosim faqet e historisë dhe lexojmë mbi biografinë e imamëve dhe dijetarëve të mëdhenj do të shohim se të gjithë ata kanë qenë bij të nënave edukatore, gjë e cila është bërë shkak, që ata të jenë pishtarë ndriçimi për njerëzimin

SAFIJE VUDGAJRI

Sot po i drejtohem çdo gruaje, që të kuptojë sa më mirë, se mbi supet e saj ka përgjegjësinë e kumtimit të amanetit në këtë jetë, që të vulosin historinë sikur e patën vulosur edhe shumë gra para nesh, të cilat ishin të parat në bartjen e xixave të suksesit. Ato duhet të bëjnë një jetë siç i ka hije çdo gruaje muslimane, të eci me hapat e

besimit drejt rreshtave të parë, t'i regjistrojnë ditët e tyre me një bojë që nuk shlyhet, që të jenë në shërbim të atyre që vijnë pas dhe që do ta gjejnë rrugën me shenjat e tyre, shenja të cilat i kanë vizatuar me mund, rraskapitje dhe punë gjatë gjithë jetës...

Këto janë grada dhe pozita gjatë të cilave duhet të përmendet emri i secilës dhe të ngrihet pozita e saj, e cila do ta shoqërojë në këtë botë dhe në botën tjetër.

Roli i saj me potencialin që zotëron është që ajo të merret me edukimin e fëmijëve, kryerjen e detyrimeve ndaj burrit të saj, si dhe të kujdeset për çdo anëtar të familjes, që mos ta harrojë historia asnjëherë.

Nëna edukatore është burimi i fuqisë së ndryshimit në shtëpinë e muslimanit, si dhe të shoqërisë në tërësi. Ekzistenca e saj është e nevojshme për shoqërinë dhe është çelësi i ndryshimeve pozitive në shoqëri. Për këtë shkak Islami i ka dhënë një përparësi të madhe profesionit të nënës edukatore, e cila synon që ta kryejë misionin e saj në formimin e shoqërisë së shëndoshë të bazuar mbi besimin. Për këtë shkak ka zgjedhur pozitën më të ndershme për të dhe të cilës nuk mund t'i bëhet rival askush e ajo është që gruaja të rrijë në shtëpi dhe të mos dalë përveç nevojave të domosdoshme, në bazë të kriterëve të Sheriatit Islam. Këto që thamë mund t'i argumentojmë me ajetin Kuranor, ku Allahu subhanehu ue teala thotë: ***“Dhe rri në shtëpitë tuaja e mos shfaqni bukurinë tuaj si shfaqej në injorancën e hershme...”*** El-Ahzab 33.

Kurtubiu Allahu e mëshiroftë thotë: Imperativi në këtë ajet është për gratë e Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem, por nuk përjashtohen edhe gratë e tjera.

Ndërsa i Dërguari i Allahut Muhamedi salAllahu alejhi ue selem thotë: ***“U është lejuar juve që të dilni për nevojat tuaja”***. (Muslimi.) Esenca e gruas është qëndrimi i saj në shtëpi, sepse natyra e saj është që ajo të merret me edukimin e fëmijëve dhe të marri pjesë në formimin e familjes. Ndërsa ata që synojnë ta destabilizojnë shoqërinë islame dëshirojnë që ajo të punojë jashtë shtëpisë. Ata mendojnë se qëndrimi i saj në shtëpi është nënçmim për te, dhe se ajo po bën jetë burgu në shtëpinë e saj, dhe se ajo nuk është e integruar në shoqëri.

Megjithatë ata ia kanë arritur qëllimit duke i përhapur mendimet e tyre, dhe ne i

“...Nënat sahabije, si dhe ato që shkuan pas gjurmëve të tyre kanë qëndruar pranë sistemit të shëndoshë, duke u mbështetur në natyrshmërinë e tyre esenciale dhe punën e tyre e konsideronin nder dhe krenari për ta...”

adoptuam dhe i kultivua filozofitë e tyre, dhe mendojmë se ajo grua, e cila punon jashtë shtëpisë është më me vlerë, se ajo që rri në shtëpi, dhe se për atë punë që bën do të ketë edhe shpërblim. Kjo gjë apo ky mendim ka bërë që gruaja ta braktisë punën e saj në shtëpi duke e nënçmuar atë dhe duke e cilësuar gruan që kujdeset për shtëpinë e saj, si shërbëtoreshë e të ngjashme. Kështu që edhe ne nganjëherë mendojmë se kjo lloj gruaje, e cila rri në shtëpi dhe i edukon fëmijët e saj është e papunë apo pa profesion.

Kjo kulturë dhe këto mendime janë bërë normale tek ne dhe brez pas brezi me një vijimësi të vazhdueshme po trashëgohen brez pas brezi. Kjo anije në të cilën jemi duke lundruar nëpër tallaze të mëdha, po e vërejmë në shumë segmente të jetës sonë, e sidomos tek fëmijët tanë. Ndërsa gruan, e cila ia ka kushtuar jetën e saj kujdesit familjar, Islami e ka bërë që për punën e saj të jetë krenare dhe se ajo me këtë veprimtari jetësore po merr pjesë në përmirësimin dhe zhvillimin e shoqërisë. Ajo grua, e cila e kupton këtë i jep mundësi edhe masës të mund të bëjë kësaj krahasimesh. Sepse gruaja, e cila punon në

shtëpi, ajo prodhon një shoqëri të tërë me plot kuptimin e fjalës duke u bërë prehe për burrin e saj dhe ndihmon kështu procesin e zhvillimit dhe të prodhimit të fëmijëve të saj. Ky prodhim sa herë që shtohet dhe rritet ndihmon procesin e zhvillimit të shoqërisë dhe shtimit të të ardhurave.

Nënat sahabije, si dhe ato që shkuan pas gjurmëve të tyre kanë qëndruar pranë sistemit të shëndoshë, duke u mbështetur në natyrshmërinë e tyre esenciale dhe punën e tyre e konsideronin nder dhe krenari për ta. E gjitha kjo, sepse ato nxirrnin gjenerata të shëndosha, duar të pastra me abdes dhe ballët, të cilët i bënë sexhde vetëm Krijuesit të tyre, Allahut subhanehu ue teala. Një gjë të tillë e dëshmon edhe historia ku nga këto nëna dolën burra që ndërtuan shtete.

Nëse shpalosim faqet e historisë dhe lexojmë mbi biografinë e imamëve dhe dijetarëve të mëdhenj do të shohim se të gjithë ata kanë qenë bij të nënave edukatore, gjë e cila është bërë shkak, që ata të jenë pishtarë ndriçimi për njerëzimin. Ne sot kemi tejet nevojë për kesi nënash, të cilat e shkruajnë historinë e tyre me duart e veta të pastra, duke mos kursyer mundin e tyre dhe duke sakrifikuar për përgatitjen e brezit të ri.

Ne po ashtu kemi nevojë për nëna që e shkruajnë historinë e tyre duke u kapur pas natyrshmërisë së vet e ajo është që të përqendrohet në shtëpi dhe të kujdeset për detyrat e saj, që të prodhojë një brez të fuqishëm para se të mendojë për ndonjë detyrim tjetër apo të marri pjesë në ndonjë zhvillim tjetër, i cili po ashtu është i nevojshëm për shoqërinë islame.

Por duke marrë parasysh, se ne jemi të nevojshëm për disa punë, që ka nevojë shoqëria islame, ne duhet të bëjmë një krahasim se në cilën sferë dobia apo dëmi është më i madh. Këtë e themi duke u

bazuar në ajetin Kuranor *“...por dëmi i tyre është më i madh se dobia e tyre...”* El-Bekare 219. Edhe nëse ka leverdi në punën e saj që kryen jashtë shtëpisë, ajo mundet që ta prishë programin e jetës shtëpiake, të shkatërrojë standardet familjare dhe ta destabilizojë jetën shoqërore duke pasur ndikim negativ tek burri dhe fëmijët e saj, e duke u larguar nga natyra, të cilën ajo e zotëron.

Elementi që ia përlyen jetën familjare, duke qenë zonjë në shtëpinë e vet dhe duke u kujdesur për fëmijët e saj, që i ka dhunti nga ana e Krijuesit është epshi, që ndjek ajo duke menduar se me punën e saj do të ndihmojë shoqërinë e do ta pengojë që ajo ta shkruajë historinë e saj dhe do të mbetet kështu një femër e thjeshtë dhe jo progresive. Në këtë mënyrë ajo ka për ta varrosur jetën e saj, duke e bërë veten të padobishme dhe nuk ka për të lënë kurrfarë trashëgimie pas.

Më në fund ne jemi të nevojshëm për gra, të cilat nuk i harron historia dhe që me veprimtarinë e tyre gjithmonë kanë qenë në harmoni me ligjet e natyrës së njerëzimit për realizimin e interesave shoqërore. Allahu subhanehu ue teala i ka krijuar njerëzit dy llojesh. Njëri janë meshkujt, kurse tjetri femrat. Çdonjëri prej tyre ka natyrën e vet, njësoj si nata dhe dita. Njëra e errët, kurse tjetra dritë. Dhe çdonjëra e ka rolin e vet në këtë jetë. Ashtu është edhe me njerëzit, ashtu siç i kanë natyrat të ndryshme, ashtu edhe detyrat dhe përgjegjësitë i kanë të ndryshme. Prej burrit kërkohet ajo gjë që është në harmoni me natyrën e tij. Kurse tek femrat kërkohet ajo gjë që është në harmoni me natyrën e saj. ■


Zgjedhi dhe përshtati:
Enver Azizi

SHTËPIA E BESIMTARIT

Këto shtëpi me dhikër, namaz dhe Kuran ndriçojnë nga nuri Islam, mbretëron hareja dhe lumturia në rrethin familjar

SHKRUAN: ZEKI ÇERKEZI

Allahu me mëshirën e Tij të pakufishme i ka krijuar njerëzit në formë të përkryer dhe ka bërë caktim për ata një formë të mrekullueshme jetese. Allahu i mësoi njerëzit që të jetojnë nëpër vendbanime, në shtëpi dhe banesa, ku njeriu mund të pushojë, në ngrohtësinë e të cilave gjen mbrojtje prej acarit të dimrit, nën hijen e të cilave gjen strehim nga vapa e verës. Gjithashtu, në shtëpi njeriu e ruan intimitetin e tij familjar nga shikimet e kureshtarëve, mbron pasurinë e tij nga vjedhësit dhe njeriu ka shumë përfitime prej shtëpisë së tij. Nga ana tjetër, Allahu i mundësoi njerëzve, në vendbanimet jashtë qyteteve, të jetojnë nëpër tenda, të cilat mund të përgatiten lehtë dhe shpejt. Allahu në Kuran thotë: ***“Allahu ju bëri shtëpitë tuaja vendbanim të qetë dhe nga lëkurët e kafshëve***



(tendat) *ju mundësoi të keni shtëpi që i bartni lehtë kur udhëtoni, e edhe kur vendoseni.*" (16: 80).

S'ka dyshim që strehimi nëpër shtëpi është një prej dhuntive më të mëdha dhe me rëndësi të veçantë. Natyra e njeriut është e tillë, që vlerën e dhuntive dhe begatitë, në të cilat jeton, i merr vesh vetëm kur i humb ato. Kështu, të mendojmë për ata të cilët nuk kanë strehim mbi kokë, nuk kanë mbrojtje nga të ftohtit në dimër. Kjo fatkeqësi ka goditur shumë familje gjatë luftës, ku janë djegur e shkatërruar shumë shtëpi. Për këtë shkak duhet t'i jemi mirënjohës Allahut dhe ta falënderojmë për këtë mirësi, për shtëpi komode, të rregulluara mirë, të rehatshme. A nuk duhet ta falënderojmë shumë Allahun për ujin që kemi brenda në shtëpi, të nxehtë e të ftohtë, të pastër e të pijshëm? Pa dyshim se duhet ta falënderojmë dhe lavdërojmë shumë.

Për këtë shkak shtëpia e besimtarit duhet të veçohet dhe të dallohet nga shtëpitë e tjera. Ajo me çka dallohen shtëpitë e besimtarëve janë veprat e urdhëruara nga Allahu, siç është të bërit dhikër (përmendja e Allahut) në shtëpi, të falurit sa më tepër i namazeve vullnetare në shtëpi, leximi i Kuranit dhe ibadete të tjera. Nga ana tjetër, gjithashtu karakteristikë e shtëpisë së besimtarit është pastrimi i shtëpisë nga gjërat e ndaluara dhe nga fjalët poshtëruese. Kështu, përcillet nga Abdullah b. Kajsi (Ebu Musa Eshariu) radijallahu anhu, të ketë thënë: i Dërguari i Allahut salallahu alejhi ue selem, ka thënë: *"Shembulli i shtëpisë në të cilën përmendet Allahu dhe shtëpisë në të cilën nuk përmendet Allahu, është si shembulli i njeriut të gjallë dhe atij të vdekur"*.¹ Ndërsa Abdullah b. Omeri

“...: “Falni namaz në shtëpitë tuaja, sepse namazi më i mirë i njeriut është në shtëpinë e tij, përveç farzeve...”

radijallahu anhu, tregon, se i Dërguari i Allahut salallahu alejhi ue selem, ka thënë: *"Një pjesë të namazeve tuaja falini nëpër shtëpi, mos i shndërroni ato në varreza."*², pra, shndërrimin e shtëpive në varreza e pengon namazi i falur në te. S'ka dyshim, qëllimi i Muhamedit salallahu alejhi ue selem, me këtë hadith është, që namazet vullnetare të falen në shtëpi sipas mundësisë. Kurse farzet, kuptohet që duhet të falen nëpër xhami. Në një hadith të saktë Muhamedi salallahu alejhi ue selem, ka thënë: *"Falni namaz në shtëpitë tuaja, sepse namazi më i mirë i njeriut është në shtëpinë e tij, përveç farzeve"*.³

Gjithashtu, ajo që e ndalon shndërrimin e shtëpive në varreza është leximi i Kuranit. I Dërguari i Allahut salallahu alejhi ue selem, ka thënë: *"Lexojeni suren Bekare në shtëpitë tuaja, sepse shejtani nuk hyn në atë shtëpi ku lexohet sureja Bekare"*.⁴

Nga gjithë këto hadithe, të cilat janë të sakta dhe gjenden në Sahihun e Muslimit, mësohet se besimtari duhet ta gjallërojë shtëpinë e tij me dhikër, namaz vullnetar etj., sepse pa dyshim që ky lloj namazi është më i vlefshëm në shtëpi se sa në xhami. Po ashtu nga këto hadithe nxitet besimtari, që të lexojë Kuran në shtëpinë e tij, dhe kështu sigurohet nga shejtani i mallkuar, sidomos nëse lexohet sureja Bekare. Këto shtëpi me

¹ Sahihu Muslim nr. 779

² Sahihul Buhari nr. 432

³ Sahihul Buhari nr. 731

⁴ Sahihul Xhamië nr. 1170

dhikër, namaz dhe Kuran ndriçojnë nga nuri Islam, mbretëron hareja dhe lumturia në rrethin familjar. Anëtarët e familjeve me shtëpi të tilla edukohen për të adhuruar Allahun dhe me respektin ndaj urdhrave të tij. Shtëpitë të tilla i kanë të hapura dyert për melaiket, kurse të mbyllura për shejtanët.

Por nëse shtëpitë nuk mbushen me këto ibadete, atëherë ato shndërrohen në varreza, gjë e cila ndikon në vdekjen e zemrave dhe nuk ka më harmoni familjare. Nëse mungesës së ibadeteve i shtohet veprimi i haramëve, atëherë katastrofa familjare është akoma më e madhe. E për fat të keq, shumica e shtëpive janë të tilla. Rrallë gjen ndonjë shtëpi pa pajisje elektronike me CD, DVD e gjëra të tjera me muzikë çoroditëse, filma me skena plot lakuriqësi dhe me tematika degjeneruese. Të gjitha këto gjëra janë vdekjeprurëse për moralin në përgjithësi, e për moralin Islam në veçanti. Prindërit që i lejojnë këso gjërash në shtëpitë e veta, mos të presin respekt nga fëmijët e tyre, e as fëmijët mos të presin nga prindër të tillë dashuri prindërore.

Shtëpia duhet të jetë e pastër edhe nga fotografitë dhe nga qentë. Këtë e vërtetojnë shumë hadithe të sakta. Bile në këto hadithe piktorët, të cilët vizatojnë gjallesa, kërcënohen me dënim të dhembshëm, çka dëshmon se vizatimi i gjallesave është prej mëkateve të mëdha. Buhariu dhe Muslimi na përcjellin nga Ebu Talha radijallahu anhu, se Muhamedi salallahu alejhi ue selem, ka thënë: *“Nuk hyjnë melaiket në atë shtëpi, në të cilin ka fotografi dhe qen”*.⁵ Në një hadith tjetër të shënuar në Sahihët e Buhariut dhe të Muslimit, që na përcillet nga Abdullah b. Omeri radijallahu anhu, i

Dërguari i Allahut salallahu alejhi ue selem, ka thënë: *“Me të vërtet, ata që i pikturojnë këto gjëra do të dënohen ashpër Ditën e Kiametit dhe do t’u thuhet atyre: Ngjallini ato që i keni bërë!”*.⁶ Gjithashtu Buhariu dhe Muslimi në Sahihët e tyre përcjellin nga Aishja radijallahu anha të ketë thënë: *“Bleva një jastëçkë me piktura të gjallesave. Kur e pa i Dërguari i Allahut salallahu alejhi ue selem, u ndal te dera, nuk hyri brenda dhe në fytyrën e tij u shpreh pakënaqësia. I thashë: o i Dërguari i Allahut! Pendo hem tek Allahu dhe tek i Dërguari i Tij, çfarë mëkati kam bërë? Më tha: Ç’është kjo jastëçkë? I thashë: E bleva për ty, që të ulesh në te dhe të mbështetesh. Më tha i Dërguari i Allahut a.s.: Me të vërtet, prodhuesit e këtyre pikturave do të dënohen dhembshëm Ditën e Kiametit dhe do t’u thuhet atyre: Jepuni jetë këtyre që ju i keni pikturuar. Dhe pastaj tha: Me të vërtetë, në shtëpinë që ka piktura nuk hyjnë melaiket”*.⁷

Besimtari i devotshëm dhe i ndërgjegjshëm, i cili dëshiron që në shtëpinë e vet ta shoqërojnë melaiket e jo shejtanët, i mjaftojnë këto hadithe të sakta. Përndryshe ka edhe shumë hadithe të tjera, të cilat flasin për këtë çështje.

Duhet ta dimë fare mirë, se Islami është fe me rregulla dhe principe, të cilat pa dyshim janë të përshtatshme dhe optimale për natyrën e njeriut. Kështu edhe shtëpia ka rregullat e veta. Islami ka vendosur rregulla mes anëtarëve të familjes, por gjithashtu ka rregulla edhe për marrëdhëniet ndërfamiljare. Bile, këto çështje ashtu janë të rregulluara në detaje, sa që besimtarit i shtohet edhe më shumë bindja për universalitetin dhe përsosmërinë e Islamit. Vërtet, këto ligje vijnë nga i Gjithëdijsmi dhe më i Urti.

⁵ Sahihul Buhari nr. 3322

⁶ Sahihul Buhari nr. 7557

⁷ Sahihul Buhari nr. 2105

Allahu i Lartmadhëruar thotë: ***“O ju që keni besuar! Le të kërkojnë lejen tuaj robërit dhe robëreshat e ligjshme dhe ata nga (familja juaj), të cilët nuk kanë arritur në moshën e pjekurisë, duhet të kërkojnë leje prej jush (për të hyrë te ju) në tri kohë: para namazit të sabahut, në kohë e drekës kur i hiqni rrobat tuaja (për të pushuar) dhe pas namazit të jacisë, që të tria këto kohë janë kur ju nuk jeni të veshur. Pos atyre tri kohëve nuk është mëkat, as për ju, as për ata për të hyrë te njëri – tjetri. Kështu Allahu ua sqaron argumentet e veta. Dhe Allahu është i Gjithëdituri, më i Urti.”*** (24:58). Këto janë rregulla të mrekullueshme. Pa këto rregulla shtëpitë nuk ndriçohen me nurin Islam, nuk ka harmoni, e as lumturi në ato shtëpi. Pra, fëmijët duhet të mësohen që mos të hyjnë në dhoma të fjetjes të prindërve pa trokitur në derë, pa kërkuar leje në ato tri kohë që përmenden në ajetin kuranor, çka do të thotë se prindërit duhet ta mbyllin dhomën e fjetjes, kur hyjnë brenda. Ndërsa anëtarët e familjes, të cilët e kanë arritur pjekurinë, duhet që në çdo kohë të kërkojnë leje para se të hyjnë tek prindërit, nëse janë vetëm në dhomën e tyre.

Kurse vizitorët, që nuk janë anëtarë të familjes dhe që nuk banojnë në atë shtëpi, nuk bën të hyjnë në shtëpi para se të kërkojnë leje për të hyrë. Allahu thotë: ***“O ju që besuat, mos hyni në shtëpitë e huaja pa kërkuar leje dhe pa përshëndetur njerëzit e saj.”*** (24 : 27). Këtë çështje e trajtojnë akoma më me imtësi dhe e përsosin hadithet e të Dërguarit salallahu alejhi ue selem, që ka thënë: ***“Leja për të hyrë në shtëpi të huaja kërkohet tri herë.***

Nëse të jepet leje hyr, përndryshe kthehu.”⁸, çka nënkuptohet se nuk kemi të drejtë të trokasim, ose t'i biem ziles, më tepër se tri herë. Në një hadith tjetër, mësojmë se Muhamedi salallahu alejhi ue selem, ***“kur i afrohej një dere dhe donte të kërkojë leje, nuk qëndronte përballë saj, por në të djathtë apo në të majtë, nëse i jepej leje hynte, përndryshe kthehej”***.⁹ Qëllimi i këtij hadithi të fundit është që kur të hapet dera e shtëpisë, i huaji mos të shohë brenda shtëpisë, ose oborrit, nëse ka shtëpia oborr. Të gjitha këto masa parandaluese janë të domosdoshme për një shtëpi të çiltër, të moralshme dhe shpirtërisht të shëndoshë. Integriteti familjar dhe jeta private në Islam janë të shenjta, të paprekshme. Islami i jep rëndësi të dorës së parë vlerave morale.

Nëpër shtëpi pa këto rregulla Kuranore dhe profetike, e me muzikë dhe me fotografi e piktura, e jo rrallë edhe skulptura, të gjallesave të varura nëpër mure, me shejtanë e pa melaïke, sigurisht se do të ketë ngatërresa ndërmjet çiftit bashkëshortor, mosrespekt ndaj prindërve dhe këto shtëpi janë kandidate potenciale për duhan, alkool, drogë, prostitucion...

Ta kuptojmë njëherë e përgjithmonë, se Islami është fe e përsosur, depërton në çdo pore të jetës së njeriut, kuptohet për të mirën e tij, për lumturinë e tij në të dyja botët.

E lusim Allahun që të na i pastrojë shtëpitë nga fjalët dhe veprat me të cilat Ai s'është i kënaqur, dhe që të na i stolisë shtëpitë me fjalë dhe vepra, të cilat Ai i pëlqen. ■

⁸ Sahihu Tirmidhi nr. 2690

⁹ Sahihul Edebil Mufred nr. 822

KURANI SHËRIM HYJNOR

Në kohën e fundit shërimi me Kuran (rukja) është përhapur dhe është bërë dukuri dhe domosdoshmëri për shumë sëmundje të njohura dhe të panjohura, mirëpo me këtë shërim merren edhe disa lexues Kurani – injorantë

ABDULLAH SED'HAN

Allahu thotë në Kuran: “O ju **A**njerëz? Juve ju erdhi nga Zoti i juaj këshilla (Kurani) dhe shërimi i asaj që gjendet ne kraharorët tuaj (në zemra), edhe udhëzim e mëshirë për besimtarët.” (Junus, 57)

I Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ue selem, thotë: “Me të vërtetë Allahu nuk ka zbritur sëmundje e të mos ketë zbritur edhe shërimin, e ka mësuar ai që ka arritur ta mësojë dhe ka mbetur injorant ai që nuk ka arritur ta mësojë, përveç vdekjes.”¹

Shpesh në jetën e përditshme na ka rënë të dëgjojmë për sëmundje të ndryshme për mënyra dhe metoda të diagnostikimit dhe trajtimit të tyre. Njeriu shpeshherë ka marrë guximin, që për shumë sëmundje të shprehet dhe të thotë, se ne i shërojmë këto e këto sëmundje, duke mos qenë në gjendje që të bëjë



¹ Sahihul Xhamië nr. 1809

dallimin në mes asaj që është mjekim dhe shërim. Bile edhe më keq ata kanë dhënë edhe diagnoza të gabuara dhe pa anamnezë (historiku i sëmundjes), kur dihet se ajo është gjysma e diagnozës, e shpeshherë nuk dihet edhe diagnoza. Qasja hyjnore na jep një fokus shumë të qartë dhe absolut, kur dihet dhe është e vërtetuar, se fjala e Allahut (Kurani) është parandaluese dhe shërim i shumë sëmundjeve, kuptohet me lejen e Allahut dhe me besim të singërtë dhe bindjen e fortë në fuqinë dhe madhështinë e Tij, në emrat e Tij të bukur dhe cilësitë e Tij absolute dhe të përsosura.

Në kohën e fundit shërimi me Kuran (rukja) është përhapur dhe është bërë dukuri dhe domosdoshmëri për shumë sëmundje të njohura dhe të panjohura, mirëpo me këtë shërim merren edhe disa lexues Kurani – injorantë, që nuk kanë njohuri mbi fenë e Allahut e sidomos në këtë lëmi (rukje), duke ia zvogëluar vlerën dhe madhështinë Kuranit. Ndërsa nga ana tjetër disa njerëz janë përqendruar vetëm në mjekësi dhe kanë lënë anash shërimin hyjnor.

Kurani është mjekim i zemrave dhe shërimi i tyre, ai është shëndet i trupave dhe shërim i tyre. Allahu i Madhëruar thotë: **“...dhe kemi zbritur prej Kuranit që është shërim...”** (El Israë, 82). Dhe shiko fjalën shifa-shërim, të cilën e ka përmendur Allahu në librin e Tij e nuk ka thënë mjekim, ngaqë krahasimi është i qartë, sepse me mjekimin njeriu ka mundësi të shërohet dhe të mos shërohet.

Ibnul Kajimi në librin e tij Zadul Mead thotë: “Kurani është shërues i të gjitha sëmundjeve shpirtërore (zemrës) dhe trupore, si dhe nga brengat e dynjasë dhe ahiretit. Nuk i mundësohet çdokujt shërimi me Kuran, mirëpo nëse i sëmuri di si ta përdorë me besim e bindje të fortë, nuk ka mundësi që ndonjë sëmundje t’i rezistojë, e

si ka mundësi t’i rezistojë dikush fjalës së Allahut, Zotit të gjithësisë. Sikur ta zbriste mbi kodra do të ishin copëtuar e mbi tokë ajo do të ishte fundosur. Atë që nuk e shëron Kurani, Allahu mos e shëroftë, atij që nuk i mjafton Kurani, Allahu mos i mjaftoftë”.

Janë disa sëmundje trupore dhe shpirtërore tek të cilat shejtani luan një rol të madh në funksionin e tyre, ngase i Dërguari i Allahut ka thënë: *“Me të vërtetë shejtani lëviz në trupin e birit të Ademit, ashtu siç qarkullon gjaku.”* (Buhariu nr. 7171)

Neuroza: është burim i shumë sëmundjeve dhe për këtë i Dërguari i Allahu i ka thënë atij njeriut, që i tha më këshillo: *Mos u mllëfos* dhe ia përsëriti disa herë (Buhariu nr. 6116). Ndikimi i neurozës në trup është i qartë, si sëmundja e sheqerit (hiperglicemia) tek disa njerëz, që vjen nga shqetësimet, si rezultat i neurozës, pastaj dhembja e kokës, tromboza, infarkti dhe paraliza e papritur. Neuroza ndikon shumë në zhvillimin e këtyre sëmundjeve dhe është bazë e çdo të keqeje.

Shumë sëmundje, si kanceri, paraliza, steriliteti, sëmundja e sheqerit, çrregullimi i ciklit menstrual, sëmundjet e zemrës janë shëruar me leximin e Kuranit. P.sh., te paraliza xhindi vendoset në atë pjesë të lëvizshme të trupit, duke e bërë të pamundur lëvizjen e saj, dhe gjatë leximit të Kuranit i sëmuri ndien sikur po i lëviz buburreci në atë pjesë të trupit dhe me lexim të vazhdueshëm xhindi nuk ka mundësi ta përballojë fjalën e Allahut.

Sëmundjet shpirtërore (Psikiatrike)-skizofrenia është një sëmundje mendore e rrezikshme, që psikiatrët e mjekojnë me injeksione dhe barna, dhe pak të sëmurë shërohen, në krahasim me trajtimin me rukje, ku janë shëruar një numër i madh prej tyre.

Edhe Vesvesja – është një çrregullim që

“Sot përhapja e madhe e kancerit të gjirit ka si shkak kryesor mësyshin, që në disa raste është shëruar me rukje...”

godet shumë njerëz, duke i futur shumë dyshime të pabazuara në jetën e tyre, si: në besim, adhurim, raportet ndërnjerëzore, farefisnore etj. Në të shumtën e rasteve shkaktar është pëshpëritja e shejtanit, duke u munduar që t'ia prishë njeriut raportin e tij me Krijuesin, si dhe me krijesat. Shërimi i saj bëhet me leximin e Kuranit dhe përmendjen e Allahut.

Kujdes – e tërë kjo që u përmend më lart nuk do të thotë që rrugët dhe mënyrat e shërimit të mos kërkojnë në institucionet mjekësore dhe shëruese, si për sëmundjet organike (p.sh., ndërhyrjet kirurgjike), ashtu edhe për ato shpirtërore, por duhet të dihet se bazë e shërimit të çdo sëmundje është Kurani Fisnik, bindja tek Allahu dhe duatë e caktuara. Edhe marrja e ilaçeve është prej shkaqeve të shërimit, ashtu siç e ka porositur i Dërguari i Allahut atë njeriun, i cili u ankua nga dhembja e barkut që të përdorë mjaltë. (Buhariu). Gjithashtu Ai thotë: *“Ju porosis për habetu seudan (kokrra e zezë), se me të vërtetë në të ka shërim për çdo sëmundje përveç vdekjes.”* (Buhariu nr. 5687).

Sëmundjet nga syri (mësyshi), magjia dhe sulmet e xhindëve. Syri apo mësyshi është prej shkaktarëve të mëdhenj për shumë sëmundje njerëzore. Argument për

këtë është hadithi sahih, që e përcjell Xhabiri nga i Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ue selem, ku thotë: *“Do të jenë të shumtë ata që do të vdesin prej umetit tim nga mësyshi pas caktimit të Allahut.”*² Një numër i madh njerëzish, që vdesin nga sëmundjet e ndryshme si kanceri, aksidentet etj. shumë prej këtyre shkaqeve për to është mësyshi pas caktimit të Allahut.

Sot përhapja e madhe e kancerit të gjirit ka si shkak kryesor mësyshin, që në disa raste është shëruar me rukje. Kurse si parandalim i kësaj sëmundje është mbulimi i pjesëve të turpshme të trupit të femrës, ashtu siç e urdhëron Islami.

Magjia (sihri) – edhe ky fenomen është i përhapur sikurse mësyshi dhe që prej tij rezultojnë shumë sëmundje: si trupore, shpirtërore e psikike. Si p.sh., magjia e ndarjes në mes të bashkëshortëve, duke filluar me urrejtje ndërmjet tyre dhe shejtani iu krijon iluzione, që ta shohin njëri-tjetrin të shëmtuar dhe nxitja e grindjeve në mes tyre dhe më në fund ndarja. Shërimi i vetëm i saj është rukja.

Sulmi i xhindëve – kjo vjen si shkak i dëmtimit të tyre apo të dashëruarit e xhindit pas njeriut, përqendrimin e ka në sistemin qendror nervor të njeriut, që shpesh shfaqet me simptoma çmendurie dhe sulmesh epileptike dhe shumica e këtyre të sëmurëve përfundojnë në psikiatri. ■

Përshtatën: Bashkim BAJRAMI dhe Arben RAHIMI

² Sahihul Xhamië nr. 1206



ÇDO BIDAT ËSHTË HUMBJE

I Dërguari, salallahu alejhi ue selem, në një hadith të tij thotë:

“Kush shpik në fenë tonë atë që nuk është prej saj, ajo është e refuzuar.”

SHKRUAN: LULZIM SUSURI

Zinxhiri i hadithit:

Hadithi përcillet nga Kasim b. Muhamedi, ky nga halla e tij e kjo nga gruaja e Profetit, *salallahu alejhi ue selem*, Aisheja, *Allahu qoftë i kënaqur me të*.

Këtë hadith e shënon Imam Buhariu, në koleksionin e haditheve të tij të sakta, nr. 2697, imam Muslimi, nr. 1718.

Rëndësia e hadithit:

Ky hadith është prej bazave më të rëndësishme të fesë sonë, i cili i përngjan peshores së anës së jashtme të veprave tona, ashtu siç është hadithi *“Punët shpërblehen sipas qëllimit”* peshore e brendshme e këtyre veprave. Pra, nëse njeriu me veprën e tij nuk ka si synim në zemrën e tij kënaqësinë e Allahut, ajo vepër nuk do t'i pranohet. Gjithashtu nëse atë vepër nuk e punon sipas mënyrës dhe rregullave të

Allahut dhe të Dërguarit të Tij, salAllahu alejhi ue selem, edhe në këtë rast nuk do t'i pranohet.

Hadithi sipas fjalëve të tij na jep të kuptojmë, se çdo vepër që nuk i nënshtrohet rregullave fetare do të jetë e refuzuar, një realitet ky që nuk mund të mohohet. Mirëpo ai sipas kuptimit të tij na aludon për një realitet tjetër, i cili na thotë, se çdo vepër që punohet sipas normave dhe dispozitave fetare padyshim do të jetë e pranuar.

Komentimi i hadithit:

“Fjala e të Dërguarit, salAllahu alejhi ue selem:

“Kush shpik në fenë tonë...”

Me këtë fjalë kuptojmë se shpikjet e ndaluara janë vetëm ato në fe e jo të tjerat, kjo për arsye se veprat ndahen në dy grupe kryesore; adhurime, dhe grupi i dytë jo-adhurime, apo punë të përditshme përmes të cilave nuk nënkuptohet adhurimi dhe afrimi tek Allahu. Në llojin **e parë** hyjnë çdo adhurim, qoftë: farz, synet apo nafile. Kurse në llojin **e dytë** futen gjërat që janë të lejuara të punohen, por veprimi i tyre nuk përmendet se nënkupton shpërblim nga ana e Zotit. Në këtë grup hyjnë ecja, fjetja, pushimi, ushqimi, arritjet teknologjike etj. Pra, çdo vepër, e cila në origjinën e saj nuk është adhurim, edhe pse këto që ne i përmendëm dhe shumë të tjera që nuk i përmendëm, nëse me këto vepruesi i tyre ka si qëllim vetëforcimin për adhurim, ndihmën e të tjerëve, përparimin e Islamit etj., ato kalojnë nga kjo origjinë në adhurime. Me rëndësi është që shpikjet në adhurime janë të ndaluara, kurse të tjerat jo. Pra, nuk lejohet shtimi në namaze nga pesë në gjashtë farze, në agjërim nga një muaj ramazan në dy muaj etj. Ndërsa shpikjet në çështjet e kësaj botë, pra, ato të llojit të dytë, nuk janë të ndaluara, pra, nuk është me rëndësi a ecën me gomar, me deve apo me

“...As shpikësi, as vepruesi i bidatit nuk duhet të presin shpërblim për veprën e tyre, por përkundrazi është rrezik që bidati t`i humbë nga rruga e drejtë...”

makinë, ose me aeroplan, sepse të gjitha janë të lejuara përderisa nuk janë mëkat. Mirëpo, kjo gjë e lejuar, a mund të kalojë në mëkat? Po, kalon atëherë kur veprohet në mënyrë të ndaluar sipas sheriatit, p.sh. nëse kjo ecje, në këmbë, me deve apo aeroplan bëhet i zhveshur nga rrobat, apo me vende të turpshme lakuriq. Prandaj, si përmbledhje e asaj që përmendëm mund të theksojmë, se çështjet e dynjasë apo gjërat që nuk janë adhurime në origjinë janë të lejuara të veprohen dhe të futet në to risi apo të shmanget diçka, por ato mund të kalojnë në adhurime nga faktorë të jashtëm, siç mund të ndodhë e kundërta e të kalojnë në mëkate, gjithashtu nga faktorë të jashtëm.

-Fjala e të Dërguarit, salAllahu alejhi ue selem;

“Kush shpik...”

Në shikim të parë nënkupton, se për shkak të shpikjeve në fe, bidateve, dënohet dhe i refuzohen veprat vetëm shpikësit, kurse ai që i ka gjetur ato bidate dhe vetëm i vepron, duke mos shtuar në to nuk ka mëkat, sepse në hadith theksohet vetëm shpikësi. Por për fat të mirë Allahu na e ka ruajtur një hadith të saktë po aq sa i pari në të cilin përmendet vepruesi i bidatit me të njëjtin refuzim sikurse shpikësi i tij. Profeti, salAllahu alejhi ue selem, në këtë hadith thotë: *“Kush punon në fenë tonë atë që nuk*

është prej saj, ajo është e refuzuar". Shënon Muslimi nr. 1718.

Imam Neveviu në komentimin e "Sahihut të Muslimit" për këtë çështje ndër të tjera thotë: Në hadithin e parë përmendej, se kush shpik një bidat të ri, ai është i refuzuar. Kurse në të dytin nuk përmendet vetëm shpikësi, por edhe ai që e gjen bidatin e shpikur e ky vetëm e punon. Me këto dy hadithe nuk ka arsye për punimin e bidatit askush, as shpikësi, e as ai që i ka gjetur bidatet e vetëm i punon si trashëgimi nga të parët e tij. Hadithet na japim të kuptojmë se të dy llojet e njerëzve janë të përmendur në këtë çështje dhe u është tërhequr vërejtja për një rrezik të tillë.

"As shpikësi, as vepruesi i bidatit nuk duhet të presin shpërblim për veprën e tyre, por përkundrazi është rrezik që bidati t'i humbë nga rruga e drejtë, si rrjedhojë e të cilit pason dënimi në botën tjetër, nëse nuk pendohen tek Zoti". Sherh "Sahih Muslim" (12/16), (këto fjalë i kam përpunuar unë, kurse nga Neveviu kam marr idenë e përgjithshme.)

Fjala e Profetit, salAllahu alejhi ue selem:

"atë që nuk është prej saj, ajo është e refuzuar"

Në këtë pjesë të hadithit përmendet çdo shpikje në fe, pa marrë parasysh, a është ajo e mirë apo e keqe. Kjo për arsye se fjalët në hadith vijnë në formë të përgjithshme, duke mos bërë kurrfarë dallimi, gjithashtu për vetë faktin se të gjitha shpikjet në fe janë të këqija, sado që njeriu mund të mendojë me logjikën e tij, se nuk janë të gjitha të tilla. Them i kështu me plot bindje për dy shkaqe: **i pari** për faktin se i Dërguari, salAllahu alejhi ue selem, nuk e bëri një dallim të tillë, duke pasur mundësi ta bënte atë dhe duke mos pasur kurrfarë pengese, që ta ndalojë, dhe shkaku **i dytë** për arsye se sikur në bidate të

tilla të kishte mirësi, madje sado pak të tilla, atëherë Allahu do të na e tregonte në Kuran, apo përmes të Dërguarit të Tij, salAllahu alejhi ue selem, duke mos i lënë njerëzit të zbulonin gjëra të tilla. Një shok i Profetit, salAllahu alejhi ue selem, në një hadith të tij thotë: "I Dërguari, alejhi salatu ue selam, kur ka ditur diçka të mirë na ka udhëzuar tek ajo dhe kur ka ditur diçka të keqe na e ka tërhequr vërejtjen prej saj". Pra, meqë ato bidate nuk janë përmendur nga burimet e fesë sonë si të mira, atëherë kjo nënkupton se nuk janë të tilla.

Kjo që u tha argumentohet edhe me këto fakte, që janë një realitet i pamohueshëm.

Në një hadith Resulullahu, salAllahu alejhi ue selem, thotë: *"Çdo shpikje është*

bidat dhe çdo bidat është humbje". Shënon Ahmed, Ebu Daudi, Tirmidhiu etj. zinxhiri i të cilëve është "i saktë", kurse në një hadith tjetër të përmendur nga imam Nesai gjendet edhe shtojca: *"Dhe çdo humbje të shpie në zjarr"*, shënon Nesai nr. 1578, shtojcë që na e saktëson shejh Albani në librin e tij "Sahih Sunen en-Nesai". Nga ky hadith kuptojmë se çdo shpikje në fe është e refuzuar, duke mos u ndaluar, as duke mos na interesuar a na duket e mirë apo e keqe.

Çdo besimtar duhet të ketë rregull të tij në këtë çështje fjalën e Abdullah b. Mesudit, *Allahu qoftë i kënaqur me të*, që na thotë: "Të punosh pak, por sipas Sunetit është më mirë se sa të punosh shumë duke rënë në bidat". Shënon Taberani në "El-Kebir" (10/207), senedin e të cilit e saktëson shejh Albani në "Sahih et-tergib uet-terhib" nr. 41.

Kurse Abdullah b. Omeri thotë: "Çdo bidat është humbje, edhe nëse njerëzit mendojnë se (ndonjë prej tyre) është i mirë". Shënon Muhamed b. Nasr el-Merveziu në librin e tij "Es-Suneh". ■

KUJTIME

nga: **Eqrem Bej Vlora**
botues: **Shtëpia e librit & Komunikimit**

Eqrem Beu më shumë na tregon neve shqiptarëve, që kemi këputur lidhjet me historinë e mirëfilltë të paraardhësit tonë nga kompleksi i vlerës së ulët të ngulitur nga sllavët ballkanas të ndihmuar nga regjime të ndryshme komuniste e të ashtuquajtur nacionaliste shqiptare. Eqrem Beu na mëson se si luftohet për vatan me iman



SHKRUAN: SEDAT SHABANI

Biografia e Eqrem Bej Vlorës

Eqrem Bej Vlora, nip i Ismail Qemalit.

CV që Eqrem bej Vlora e ka shkruar me dorën e vet në italisht:

2Dhjetor 1886, i lindur në Vlorë nga Syrja bej Vlora dhe Mihrie Toptani. 1891-1896, Studimet elementare dhe gjimnazin me profesor privat. 1900-1906, Studimet liceike dhe universitare K.U.K. Theresianum, Akademia Orientale Vjenë. 1906, Sekretar i gradës së III në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Perandorisë Osmane, Stamboll. 1907, Sekretar i gradës së III në Ambasadën e Perandorisë Otomane në Shën Petërburg. 1909, Sekretar i II në zyrën e përkthimeve Ministria e Punëve të Jashtme të Perandorisë Osmane-Stamboll. 1 Nëntor 1912, Anëtar i Asamblesë Kushtetuese për Pavarësinë e Shqipërisë. 1913, Senator-Zëvendës President i Senatit (Pleqësia). 1914, Zv/Sekretar i Shtetit në Ministrinë e Punëve

të Jashtme Shqiptare. 1921, Kryetar i Bashkisë Vlorë. 1923, Deputet i Asamblesë Kushtetuese. 1925, Senator. 1925, Ambasador i Shqipërisë në Londër. 1929, Ambasador i Shqipërisë në Athinë. 1932, Drejtor i Punëve Politike në Ministrinë e Punëve të Jashtme Tiranë. 1934, Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Jashtme Shqiptare, grada Ministër (i plotfuqishëm). 1937, Deputet i Vlorës. 1939, Këshilltar Shteti. 1940, Kryetar i Zyrës së Punëve Civile, Kryetar i Zyrës Ceremoniale në “Luogotenencia” Tiranë. 1942, Ministër i Tokave të Çliruara, Ministër i Kulturës. 1943-44, Ministër i Punëve të Jashtme të Shqipërisë.

Titujt: 1904, Kalorës, 1906, Komendator i urdhrit Osman Mexhidie, 1907, Kalorës i Urdhrit të Leopoldit Belgjikë. 1908, Medalje e fushatës Edzekaz. 1914, Komendator i Urdhrit Shqiptar Skënderbej. 1927, Oficer i Kurorës së Italisë. 1934, Oficer i Urdhrit Karagjergjoviç. 1935, Oficer i Yllit të Rumanisë. 1935, Anëtar i Akademisë së Shkencave Gjermanike Humboldt. 1935,

Medalje Ari e Akademisë së Shkencave Gjermanike Humbold. 1936, Anëtar i Akademisë Diplomatike –Paris. 1941, Anëtar i Institutit të Shkencave –Tiranë. 1941, Kordon i Urdhrit të Skënderbeut. 1954, Anëtar i Institutit të Shkencave –Romë.

Publikime: 1907-Qëllimi dhe e ardhmja e Shqipërisë, Vjenë – Gjermanisht; 1908, ABC Pellazgjike, Stamboll. Shqip (përkth.); 1909, Nga Berati dhe prej Tomori, Instituti i Studimeve Ballkanike-Sarajevë-Gjermanisht; 1910, E vërteta mbi politikën e Xhonturqve në Shqipëri, Vjenë, Gjermanisht; 1913, Dhimbjet e popullit Shqiptar, Romë- Italisht, 1934—Vepër në gjermanisht; 1935, Forca e Popullit Shqiptar, (Enciklopedia e Akademisë Diplomatike) Paris, frëngjisht; 1956, Turkenherschaft in Albania (gjermanisht).

Për botimin e librit “Kujtime” u njoha për herë të parë në vitin 2001 në një kolonë të Veton Surroit, ku citonte Ministrin e Brendshëm të Turqve të Rinj, armikut të madh të shqiptarëve z. Talat Pasha, ku me pesimizëm të thellë për çështjen asokohe kombëtare dhe paaftësinë për udhëheqje politike të lidërshipt kosovar kishte marrë si shembull citatin nga libri dhe thoshte, se si duket në të vërtetë na ka zënë nëma e turqve për privilegjet, që kemi gëzuar në atë periudhë, ku po citoj :

“Ose qëndroni nëpunës dhe binduni mësimëve të Qeverisë, ose bëhuni politikan dhe përfaqësoni idetë tuaja, si deputet në parlament. Vetëm duhet të keni parasysh një gjë: Unë i njoh Shqipërinë dhe shqiptarët më mirë sesa mendoni ju. Ju keni jetuar në Perandorinë Osmane jo si të shtypur dhe të nënshtruar, por si zotërinj dhe urdhërues. Ju keni përfituar nga pushteti i Perandorisë dhe i fesë më tepër se turqit. Tani po bëheni renegatë dhe kërkonin ta përmbysni anijen që po mbytet, në vend që të punoni dorë për dorë me ne për shpëtimin e saj. Ndoshta një ditë edhe do t’ia arrini asaj që kërkonin. Vetëm

kujdes! Shqipëria është e vogël dhe e varfër. Shqiptarët nuk janë, as qytetarë të mirë, as punëtorë të mirë. E shumta ata mund të jenë sundimtarë të mirë dhe ca më tepër kusarë të mirë. Një ditë prej ditësh, kur të mos i keni më kullotat e majme të kësaj perandorie, ju do të hani njëri-tjetrin në atë Shqipërinë e ngushtë dhe të varfër!” Ai nuk foli atëherë si ministër, por si një turk i thjeshtë. I bindur dhe i ndershëm. Dhe kishte pasur të drejtë”. (f. 126)

Pa dyshim libri jo mua, por në përgjithësi çdokujt që iu ka dhënë mundësia ta lexojë i ka lënë mbresa të thella shumëkujt, edhe ia ka ndryshuar bindjet duke iu bërë pusullë historike për periudhën më të rëndësishme e njëkohësisht më të lavdishme të popullit tonë. Vetë fakti se pas botimit të këtij libri, në vendlindjen e tij Vlorën e lavdishme bashkëkombësit e tij dhe qytetarët pas disa dekadash e dekoruan me fjalë miradije, ku veçoj konferencën e mbajtur në shtëpinë e Eqrem Beut në Vlorë me temë “Eqrem bej Vlora – patriot, intelektual i madh dhe burrë i shquar shteti”.

Pas himnit të Flamurit, Qëndro Meminaj, sekretari i klubit “Ali Asllani”, tha: “Është hedhur shumë baltë nga regjimi komunist kundër Eqrem bej Vlorës, bejlerëve dhe agallarëve të tjerë të të gjithë Shqipërisë, si njerëz të pashpirt, që shikonin rehatinë e tyre apo tradhtar e bashkëpunëtor me armiqtë e kombit shqiptar. Por përralla të tilla si këto e të tjera, tani u ka dalë boja dhe bile u ka kaluar shumë koha. Prandaj është e domosdoshme se sa më shpejt të jetë e mundur Eqrem bej Vlorës dhe figurave të tjera të shquara të popullit tonë t’i jepet vendi i nderit, në altarin e historisë kombëtare shqiptare.”

Eqrem Beu edhe pse librin e shkroi për t’i treguar evropianëve kryelartë për aristokracinë shqiptare të periudhës kur ai jetoi, tregoi se shqiptarët nuk janë siç i ka

përshkruar Bizmarku i “famshëm” me bishta, por Eqrem Beu më shumë na tregon neve shqiptarëve, që kemi këputur lidhjet me historinë e mirëfilltë të paraardhësit tonë nga kompleksi i vlerës së ulët të ngulitur nga sllavët ballkanas të ndihmuar nga regjime të ndryshme komuniste e të ashtuquajtur nacionaliste shqiptare. Eqrem Beu na mëson se si luftohet për vatan me iman, se si kur ke dinjitet ta kanë lakmi shtatë krajli në Evropë, ku edhe mbreti i Serbisë Aleksandër Obrenoviç më 1895 vjen në oxhakun e Vlorajve dhe huazon nga beu karrocën të shëtisë dhe të flladitet në brigjet e detit shqiptar...

Ajo që e karakterizon këtë libër dhe nxit kureshtjen e lexuesit janë disa “mistere” dhe enigma historike, jo vetëm të popullit tonë, por edhe më gjerë, si bie fjala:

-Simpatinë e rilindësve shqiptarë ndaj sulltanit:

“Ne, nationalistët shqiptarë nuk ishim aspak armiq të Perandorisë, por donim të punonim në të mirën e saj me mjete të tjera.”

- Flamurin që u ngrit në Vlorë, ku thotë: “Askush më parë, as s’e kishte parë, as s’e kishte mbajtur. Askush në Vlorë nuk kishte flamur në shtëpi. Shtetformuesit ranë në hall dhe vështruan njëri-tjetrin të hutuar. Atëherë ngrihet miku im Hyдай Efendiu dhe thotë se në dhomën e gjumit të Eqrem Beut varet në mur një flamur shqiptar i futur në një kornizë të bukur dhe pyeti, se a mund të merrej pa qenë aty i zoti. Ismail Beu i dha leje dhe kështu flamuri që dikur Don Aladro Kastrioti ma kishte dhuruar solemnisht në Paris...”

Pastaj tregon se ka pasur të tillë që kanë shpresuar se po të ishte gjallë Syria Beu (babai i Eqremi), se do të kishim në flamur suret e bukura të Kuranit, po ç’mund të presësh tjetër nga Ismail Beu, që e ka kaluar gjithë jetën në vendin e frëngjve! (Vol. II-të, f. 14)

“Haxhi Muhamet efendiu shprehte zemërimin tek Ismail beu, se kishte zgjedhur një “korb” si simbol të “Shqipërisë së lirë” ...”

Haxhi Muhamet efendiu shprehte zemërimin tek Ismail beu, se kishte zgjedhur një “korb” si simbol të “Shqipërisë së lirë”.

- Gjenezën e themeluesit të Turqisë moderne Mustafa Kemal Atatürk dhe qëndrimin e tij të prerë për përdorimin e shkronjave arabe në shkrimin e shqipes (f. 247).

“Më kujtohet mirë në takim shumë interesant, që pata rastësisht me Mustafa Qemalin në vitin 1910, atëkohë ende një toger i thjeshtë. Për ne ai ishte (dhe këtë mendim kemi edhe sot) me prejardhje shqiptare. I ati i tij më 1878 u shpërngul nga Leskovci (Serbia jugore), vend i banuar prej shqiptarëve, dhe u vendos në Prishtinë. E ëma ishte shqiptare nga Parga e Greqisë”. (f. 246 – dëshmitë zyrtare kanë qenë deri në 1944 në arkivin e Prishtinës).

- Eqrem Beu është i vetmi që e konteston patriotizmin e Avni Rustemit. “Një djalosh i quajtur Avni Rustemi, një nga studentët më të pasuksesshëm, që me këtë vrasje donte të bënte emër, nuk ishte veçse një vegël në duart e kundërshtarëve të Esat pashës. Ata i dhanë mjetet e nevojshme për këtë vrasje dhe morën njëherësh përsipër mbrojtjen e tij para gjykatës franceze. Se kush ishin, këtë sot vështirë ta thuash... “Vrasës i pabesë, që kapardisej në Tiranë si shpëtimtari i atdheut”, “karagjoz politik”. Edhe pse nuk e përkrah Esat Pashën: “Që Esat pasha në çdo vend të qytetëruar do ta kishte hak

trekëmbëshin, kjo nuk diskutohet. Por që ai u eliminua në këtë mënyrë të padenjë, kjo nuk i nderon aspak anëtarët e asaj qeverie” (faqe 166).

- Hajredin Pasha, sakrificë e dibranëve. Autori na tregon se si Hajredin Pasha kishte kërkuar besë nga dibranët e ata e kushtëzuan të lejë armët, por e thyen besën në Fushë Gjoricë masakruan ushtarët e çarmatosur.

Shqiptari që tentoi të ndalte krijimin e shtetit të Izraelit

“Më kujtohet mirë sesi në dhjetor të vitit 1903 unë u ndodha rastësisht në pallatin e Vezirit të madh të atëhershëm, Ferit pashë Vlorës. Ai na tregoi se pasdite do të priste Baron Rotçildin nga Parisi. Më vonë mësuam se Rotçildi kishte kërkuar marrjen në koncesion për 99 vjet, të 20.000 hektarëve tokë (duna rëre) në Tel-Aviv, për të cilën ai ishte gati t’i paguante Qeverisë një qira mjaft të lartë.” - kujton në librin e tij Eqrem bej Vlora duke shtuar se Veziri i madh nuk pranoi në asnjë mënyrë të ndihmonte në këtë marrëveshje.

Eqremi shënon, se që ky komision kishte punuar mirë, kjo dukej dhe këtë e provonte mënyra e shkathët dhe e zgjuar, me të cilën në çastin e përshtatshëm, çifutët ua merrnin pronësinë arabëve të paditur dhe shkapërdarë. Në plotësimet që Eqrem Bej Vlora i bën këtij problemi, ai e sheh këtë situatë të krijuar si shumë të favorshme për lindjen e konflikteve dhe akteve të dhunës. Ai nuk fajëson çifutët për këtë, por atyre që ua treguan rrugën dhe ua sheshuan sionistëve rrugën për në Palestinë, pra, anglezëve. Sipas Eqrem Bej Vlorës, kur ky mision filloi t’i kapërcejë caqet e parashikuara, jo vetëm nuk i shërbeu, përkundër i dëmtoi interesat britanike. E si pasojë e kësaj, politika angleze filloi të punojë vërtet në mënyrë aktive kundër ngulitjes

masive të çifutëve në Palestinë, por ishte shumë vonë, lumi i imigrimit çifut nuk mund të përmbahej dot.

Eqremi kujton fjalët e Ferit Pashë Vlorës, shqiptarit që kundërshtoi krijimin e shtetit izraelit, të cilat ia ka thënë privatisht në rrethin e të afërmeve të tij, mbi çështjen sioniste në Palestinë: “Ne jemi ngopur me problemet etnike të maqedonasve, grekëve, armenëve dhe nuk kemi asnjë leverdi, që tani të arnojmë një problem etnik arabo-çifut. Palestina ka qenë dikur çifute, por që nga koha e Solomonit të madh e Davidit të vogël kanë kaluar mijëra vjet. Me të drejtë apo pa të drejtë, sot ajo është 100 përqind arabe dhe Perandoria Osmane nuk ka arsye, qoftë politike, qoftë sentimentale ta ndryshojë këtë gjendje”. Por Veziri shqiptar nuk kishte mundësi të frenonte dhënien e tokave me koncesion, apo fluksin e çifutëve që nisën të zinin vend rreth Izraelit, Sulltani i kishte bërë ndërkohë pazaret e mëdha.

Pushtimi i Shkupit nga Lëvizja kombëtare shqiptare

Po e përfundoj shkrimin me një fragment nga libri, pikërisht nga pushtimi i Shkupit, nga Lëvizja Kombëtare Shqiptare. Eqrem Bej Vlora ia qëndisi Shkupit këtë përsëkrim të mrekullueshëm që meriton të gdhendet me përkushtim nga bijtë e qytetit.

“Tani takoja në çdo hap shqiptarë të armatosur, që së bashku me banorët vendas kalonin të qetë nëpër rrugë. Të gjitha tregtoret ishin në punë, të gjithë dyert e shtëpive të hapura. Nëpër kafene shihje madje edhe oficerë turq (por natyrisht, jo Turq të Rinj) zyrat e administratës së vilajetit dukej se punonin, së paku, nëpunësit ishin në krye të detyrës, nëpër qytet silleshin, e madje krejt të patrazuar edhe të huajt, ndërsa edhe serbët edhe bullgarët e urryer. Vetëm klubi i Turqve të Rinj (Itikhat ve terakki) ishte pushtuar nga shqiptarët. Flamuri osman

varej në të gjitha ndërtesat publike. Ishte një revolucion, gjë që vihej re në të gjitha pamjet e jetës publike, por një revolucion pa teprime, pa tubime, pa britma, pa dhunën e skllëvërve që kanë shpërthyer burgun, ishte protesta e një populli zotëri kundër fyerjeve të pësuar. Asnjë komb në botë, pas dy kryengritjeve të shtypura përgjakshëm, pas një suksesi siç ishte pushtimi i kryeqendrës së provincës, pa organizim ushtarak, pa një hierarki të qartë e të njohur ligjërish, pa ju trembur pasojave të një veprimi të dhunshëm, pa asnjë kontroll, të mund të sillen në mënyrë kaq të shkëlqyer, kaq të qytetëruar dhe njerëzorë, si këta fshatarë të varfër të “Shqipërisë së egër”, të cilët shpesh, me një përkujdesje fëmije, zbërthenin nyjën e shamisë së tyre për të nxjerrë që andej një piastër – mbase të fundit – e të blinin me të pak bukë e djathë, ndërkohë që mbronin interesat e bashkësisë. Vetëm se ky popull zotëri, të cilin unë, si atëherë edhe sot, e dua me gjithë shpirt, sepse ai, me vetitë dhe veprat e tij fisnike përfaqëson këngën e fundit të eposit heroik evropian. Ky popull nuk ka pasur kurrë fat me udhëheqësit e vet, të mëdhenj a të vegjël, e sidomos me ata, të cilët në kontakt me kultura të huaja kanë humbur autoktonin e trashëguar! Shtresa e mesme dhe e lartë e Shqipërisë, me pak përjashtime, që nga mesi i shek. të 19-të e sot kanë qenë shpirtërisht, shpesh, në lartësi, por moralisht të padenjë për të udhëhequr këta njerëz të mrekullueshëm. Më sa duket kontakti me botët e huaja, jo vetëm i vyshk, por edhe i kalb fare lulet në kohën e pjekurisë dhe frutat e vjetra dhe të reja të natyrës shqiptare. (f. 279). ■

REPUBLIKA POPULLORE E BANGLADESHIT

SHKRUAN: DRITON LEKAJ



TË DHËNA TË PËRGJITHSHME:

Emri i plotë: Republika Popullore e Bangladeshit
Kryeqyteti: Daka

Sipërfaqja: 147.750 km

Banorët deri më 2007: 150.448.340

Përqindja vjetore e rritjes së popullsisë (2000 - 2005): 2.1 %

Përqindja e muslimanëve: 95 %

Gjuha: Bengali

Monedha: Taka (BDT)

Pavarësia: 26 Mars 1971 (nga Pakistani)

Anëtar i Kombeve të Bashkuara: 17 Shtator 1974

Anëtar i Konferencës Islamike: 1974

Bangladeshi është një shtet aziatik, i cili ndodhet në jug-qendër të Azisë. Bangladeshi kufizohet me Indinë dhe Burmën (tani: Mianmar) dhe është fqinje e Kinës, Nepalit dhe Bhutanit.

Çlirimi islam i vendit të Bengalëve (Bangladesh: Desh d.m.th. vend) filloi me Muhamed Bahtijar Halxhin, komandant i Sulltanit Muizudin Muhamed Gurit në vitin 602 h. - 1205. Atë e sunduan më pas një numër familjesh dhe Sulltanësh të ndryshëm gjersa e bashkoi Sulltani Ekber i Mogulëve me perandorinë e tij në vitin 984 h. - 1576, ndërsa ra në duart e Anglezëve në vitin: 1171 h. - 1757. Kur u formua Pakistani në vitin 1947 Bangladeshi përbënte Pakistanin lindor gjersa u pavarësua nga Pakistani më 1971 dhe u emërtua me emrin: Bangladesh.

Bangladeshi është një vend i varfër, por që premtan për një ekonomi të mirë në të ardhmen. Në të prodhohet: Oriz, Jute (ang.), kallam sheqeri, çaj. Ai zotëron një pasuri të madhe në blegtori, që i tejkalon 25 milion kokë lopë e buallica. Gjithashtu gjuetia e peshkut sjell në mbi 840. 000 ton në vit.

Bangladeshi ka mungesë të burimeve

minerale, si dhe përballat me ciklonet e ashpra, të cilat e godasin atë kohë pas kohe. Vlen të përmendet ai që e goditi atë më 30 prill të 1991, i cili shkatërroi brigjet e tij duke vrarë më se 100. 000 njerëz dhe duke lënë më se 10 milionë të tjerë pa strehë.

Sidoqoftë fuqia e madhe punëtore dhe pasuria, e cila derdhet nga hyrjet e punëtorëve jashtë vendit janë një mundësi e mirë për Bangladeshin, por zhvillimi i ngadalshëm i adresohet qeverisjes së dobët dhe neglizhencës së institucioneve publike.¹

Dendësia e banorëve është një shkak i shpërnguljes drejt shteteve të Gjirit Persik dhe në lindje drejt Singaporit dhe Hong Kongut. Vlen të përmendet se Bangladeshi është një prej vendeve me dendësi më të madhe banorësh, sepse është i vogël në krahësim me numrin e madh të banorëve të tij, i cili tejkalon shifrën prej 150 milion banorë.²

Shumica e banorëve të Bangladeshit janë muslimanë, si dhe fe shtetërore e vendit është Islami. Ka edhe fe të tjera si Hindusë dhe budistë etj., por këto përbëjnë një pakicë të vogël banorësh. Bangladeshi radhitet si vendi i katërt mysliman për nga numri i banorëve pas: Indonezisë, Indisë dhe Pakistanit.

Pas një kohe të gjatë ku vendi pati përjetuar një veçim të shkollimit islam nga procesi i edukimit, kohëve të fundit Bangladeshi është duke përjetuar një ringjallje në këtë aspekt dhe dëshmia më e mirë është Universiteti Islamik Botëror, i cili ka si qëllim të ofrojë shërbimet e tij për Bangladeshasit, si dhe për muslimanët e pakicave përreth.³ ■

¹ Sipas raportit të Bankës Botërore. (wikipedia.org)

² Dendësia e banorëve llogaritet të jetë 1.045 banorë për një km² (që d.m.th. 2.45 % të banorëve të tokës jetojnë në Bangladesh).

³ http://www.islam.gov.kw/site/meet_consult/details.php?data_id=111

RRETH HAXHILLËKUT

PËRGATITI: MUHARREM ISMAILI

1- Pyetje: Cila është dispozita e haxhillëkut dhe çfarë kuptimi ka fjala haxhillëk?

Përgjigje: Haxhillëku në aspektin gjuhësor (Haxhxxh) do të thotë: qëllim, ndërsa në aspektin terminologjik do të thotë: afrim tek Allahu subhanehu ue teala me kryerjen e të gjitha detyrimeve të haxhillëkut në bazë të asaj që është përmendur në Sunetin e Muhamedit salAllahu alejhi ue selem.

2- Pyetje: Cilat kushte duhet plotësuar për të shkuar në haxhillëk?

Përgjigje: Haxhillëku ka disa kushte dhe po që se njëri prej tyre mungon dhe nuk mund të plotësohet, atëherë besimtari nuk ka mëkat nëse atë vit nuk udhëton për në haxhillëk.

Kushtet e haxhillëkut janë:

Islami, që nënkupton se për qafirin nuk është detyrim

Liria që nënkupton të mos jetë i robëruar

Haxhillëku është farz për çdo mysliman dhe kjo gjë argumentohet me Kuran, Sunet dhe konsensusin e myslimanëve, ndërsa pozita e këtij veprimi në Islam është të qenit njëra nga pesë shtyllat e Islamit.

Allahu subhanehu ue teala thotë: *“Aty ka shenja të qarta: vendi i Ibrahimit dhe kush hyn në te, ai është i sigurt. Për hir të Allahut, vizita e shtëpisë (Qabes) është detyrim për atë që ka mundësi udhëtimi tek ajo, e kush nuk e beson (ai nuk e viziton); Allahu nuk është i nevojshëm për (ibadetin që e bëjnë) njerëzit.”* Ali Imran: 97

Ebu Hurejra radijellahu anhu përcjell se Muhamedi salallahu alejhi ue selem ka thënë: *“O ju njerëz me të vërtetë Allahu ua bëri haxhillëkun detyrim, kryeni haxhillëkun.”*¹

Të jetë i mençur

Të jetë në bylyk, moshën që kërkohen prej tij ibadetet dhe

Të ketë mundësi në të gjitha aspektet

3- Pyetje: Si komentohet pjesa e ajetit: *“për atë që ka mundësi”*, e cila është përmendur si kusht për kryerjen e haxhillëkut?

Përgjigje: Mundësia që përmendet si kusht dhe që nëse e plotëson besimtari, atëherë automatikisht ai detyrohet të udhëtojë për në haxhillëk atë vit është që ai duhet t'i zotërojë mjetet për shkuarje dhe kthim nga haxhillëku dhe në të njëjtën kohë t'i lejë të holla familjes së tij, aq sa ju mjaftojnë deri sa të kthehet ai nga udhëtimi e që vlerësohet me standardin

Në këtë rubrikë mirëpresim të gjitha pyetjet e juaja, ndërsa ato më interesante do të botohen. Pyetjet mund t'i dërgoni në revista@albislam.com

mesatar të jetesës në atë vend. Pra, në fund themi, nëse ke aq të holla sa të shkosh dhe të kthehesh nga Meka, nxito dhe regjistrohu të shkosh, sepse edhe kjo mundësi jo gjithmonë është e mundshme. Mos ki frikë varfërinë, sepse Ai që ta ka mundësuar të fitosh deri tani, do të ndihmojë edhe më shumë kur ti respekton urdhrat e Tij.

4- Pyetje: A lejohet që borxhliu të udhëtojë në haxhillëk dhe a duhet kërkuar leje prej borxhdhënësit?

Përgjigje: Borxhliu nuk detyrohet të udhëtojë për në haxhillëk, përveç nëse afati i kthimit të borxhit është i gjatë dhe borxhliu është i bindur se ka mundësi që ta kthejë borxhin në afatin e caktuar dhe në të njëjtën

borxhdhënësi.

5- Pyetje: A lejohet të shkuarit në haxhillëk **Bedel**, ju lutem që të më tregoni ndonjë argument nga Kurani apo Suneti pa marrë parasysh se: a lejohet apo nuk lejohet dhe në qoftë se lejohet: a ka rregulla?

Përgjigje: Më lart treguam se njëri nga kushtet e haxhillëkut është mundësia dhe jo rastësisht kemi thënë: **mundësia në të gjitha aspektet**, për të përfshirë me këtë fjali të gjitha mundësitë ekonomike, shëndetësore e të tjera. Bedel quhet ai i cili shkon të kryejë haxhillëkun për dikë tjetër. Bedeli lejohet për personat, që kanë mundësi ekonomike, por ju mungon shëndeti, që do të thotë se nuk kanë mundësi t'i përballojnë vështirësitë gjatë



kohë i zotëron të hollat që i nevojiten gjatë udhëtimit për në haxhillëk, atëherë themi se këtij personi i lejohet që të udhëtojë dhe nuk ka nevojë që të kërkojë leje nga borxhdhënësi, sepse borxhliu nuk do ta kalojë afatin e fundit në kthimin e borxhit sipas bindjes së tij inshaAllah.

P.sh., një person ka marrë hua një shumë prej 3000 euro nga shoku i tij në muajin gusht të vitit 2008, afati i fundit për kthimin e borxhit është deri më shtator të vitit 2009, haxhillëku fillon në dhjetor të vitit 2008 dhe borxhliu i zotëron të hollat për në haxhillëk dhe është i bindur se deri në shtator të 2009 do t'i sigurojë të hollat, sepse ai e ka zakonisht fitimin 500 euro në muaj dhe nuk përbën problem për të, që ta mbledhë një shumë prej 3000 eurosh; këtij i lejohet të shkojë në haxh dhe nuk i duhet kërkuar leje nga

udhëtimit në haxhillëk, ose për besimtarët që kanë ndërruar jetë pa e kryer këtë detyrim. Duhet ditur se kjo vlen për të vdekurit, pleqtë e lodhur dhe për ata që kanë sëmundje, të cilat në të shumtën e rasteve nuk shërohen, ndërsa ata që janë të sëmurë me ndonjë sëmundje që shpresohet shërimi, këtyre nuk iu lejohet të dërgojnë bedel.

Këto shkurtimisht ishin disa rregulla, që duhet pasur parasysh gjatë dërgimit të bedelit në haxhillëk, sepse kjo punë është ibadet me të cilin shpresohet shpërblymi i Allahut subhanehu ue teala dhe mu për këtë duhet pasur frikë Allahun subhanehu ue teala gjatë bërjes së kësaj vepre, si pala që dërgon bedel ashtu edhe pala që shkon bedel për dikë.

Ky veprim (i bedelit) tek disa është bërë rrugëdalje për hile, vetëm e vetëm pse nuk

mund të durojë njerëzit e shumë në haxhillëk çon bedel, ai tjetri nuk mund ta lejë dyqanin vetëm dhe si alternativë më të mirë e gjen bedelin, kurse ai tjetri bedelin e sheh si variant më të lirë dhe e shfrytëzon këtë shans... Allahu na ruajt.

Sa i takon pjesës tjetër të pyetjes, se çështja e bedelit, a mbështetet në argumente fetare? atëherë themi: po, kjo çështje gjendet në jetën e Muhamedit salAllahu alejhi ue selem dhe në praktikën e shokëve të tij fisnikë, Allahu qoftë i kënaqur me ata. Abdulla b. Abasi na përcjell se një grua prej fisit të Hathamit shkoi tek Muhamedi, salAllahu alejhi ue selem, dhe i tha: *O i Dërguari i Allahut, babait tim i është bërë detyrim haxhillëku në pleqëri dhe ai nuk mund të qëndrojë mbi mjetin e udhëtimit, a mundet që unë të bëj haxhillëkun në vend të tij?* Muhamedi, salAllahu alejhi ue selem, iu përgjigj: *“Po, mundet”*.² Po ashtu na përcjell Abdullah b. Abasi, se dikush dëgjoi një zë duke thënë *“lebejke Allahume an Shubrume”*,³ Muhamedi salAllahu alejhi ue selem e pyeti: *Kush është Shubrume?* Ai u përgjigj: *vëllai im ose i afërmi im* (dysim i transmetuesit). Muhamedi, salAllahu alejhi ue selem, e pyeti: *A ke qenë në haxhillëk për vete?* Ai u përgjigj: *Jo*. Muhamedi, salAllahu alejhi ue selem, i tha: *Së pari, bëje haxhillëkun për vete e pastaj shko në haxhillëk për Shubrumen*.⁴

6- Pyetje: Sa është e lejuar që femrat të shkojnë në haxhillëk (bedel) për meshkujt dhe e kundërta, ju lutem a ka ndonjë argument për këtë çështje?

Përgjigje: Ndryshimi i gjinive nuk ndikon aspak në pranimin e haxhillëkut dhe nuk prish punë që burri të shkojë në haxhillëk për

një grua apo gruaja të shkojë në haxhillëk për një burrë.

Abdullah b. Abasi përcjell, se një grua prej fisit Hatham shkoi tek Muhamedi, salAllahu alejhi ue selem, dhe tha: *O i Dërguari i Allahut, babait tim i është bërë detyrim haxhillëku në pleqëri dhe ai nuk mund të qëndrojë mbi mjetin e udhëtimit, a mundet që unë ta bëj haxhillëkun në vend të tij?* Muhamedi, salAllahu alejhi ue selem, iu përgjigj: *“Po, mundet”*.

Është me rëndësi të përmendet se për të shkuar bedel për dikë nuk është kusht që ta kesh të afërm.

7- Gjyshti im ndërroi jetë dhe nuk pati mundësi që ta kryejë detyrimin e haxhillëkut, ndërkohë që ai ka lënë një pasuri mjaft të madhe për trashëgimtarët, si duhet vepruar në këtë rast?

Përgjigje: Ajo që duhet të bëni ju si trashëgues të tij është që të dërgoni dikë bedel në haxhillëk për gjyshin tuaj, sepse haxhillëku është borxh i tij, që mbetet detyrimi juaj që ta ktheni. Muhamedi, salAllahu alejhi ue selem, ka thënë: *“Borxhi ndaj Allahut është më prioritar që të kthehet”*.⁵ Dërgimi i bedelit bëhet me pasurinë e të vdekurit para se të ndahet pasuria ndërmjet trashëgimtarëve, ndërsa pasuria që mbetet lejohet që të ndahet ndërmjet tyre. Këtë e keni detyrim që ta bëni pa marrë parasysh se i vdekuri e ka regjistruar apo nuk e ka regjistruar çështjen e bedelit në testamentin e tij, por veproni ashtu siç keni vepruar me borxhet e tij, që ia keni pastruar, edhe pse ai nuk e ka kërkuar një gjë të tillë në testamentin e tij prej jush. ■

1 Sahihu Muslim nr. 1337


2 Sahihul Buhari nr. 1855

3 Që d.m.th. “Të përgjigjem o Allah për (ta kryer haxhillëkun për) Shubrumen”. Pas kësaj fjale fillojnë adhurimet e haxhillëkut sepse kjo fjalë është edhe nijeti për të filluar haxhillëkun.

4 Sahihu Ebi Davud nr. 1811

5 Sahihul Buhari nr. 1953

HISTORIA E PALESTINËS SË VJETËR (II)



ÇIFUTËT NË PALESTINË

TARIK SUVEJDAN

Endja nëpër tokë

Me të vërtetë zemrat si zemrat e Beni Israilëve nuk del nga ato sot mëshirë për askënd, prandaj askush mos të mashtrohet me kurthet dhe hipokrizitë e tyre! Ata fshehin të kundërtën e asaj që shfaqin. Në zemrat e tyre bartin urrejtje, smirë dhe zili ndaj të gjithë njerëzve të tjerë. Ata nuk kanë

as shokë, as miq, nuk kanë as besë, as besnikëri. Kanë jetuar dyzet vite duke bredhur e duke bërë mëkate ndaj Allahut dhe nuk i nënshtroheshin urdhrave të Zotit të Lartmadhëruar. Në mesin e tyre kanë pasur pejgamberin e vet Musain, alejhi selam. Më pas Allahu e dërgon Melekul-Meutin (engjëllin e vdekjes) te Musai alejhi selam ta pyesi: A dëshiron të jetosh edhe më apo të vdesësh. Musai alejhi selam e luti Zotin e Lartmadhëruar, që t'ia marr shpirtin afër

tokës së shenjtë Makdisit, kështu që Melekul-Meuti ia mori shpirtin në afërsi të Bejtul-Makdisit, aq larg sa mundet të hidhet guri. Mes tyre dhe Kudsit ka qenë vetëm një dunë¹ e kuqe. Megjithatë ata nuk e kanë ditur rrugën për në Bejtul-Makdis, dhe ata vazhduan të endeshin duke bredhur, dhe nuk mundeshin të dilnin nga kjo situatë ndërsa Musai alejhi selam ndërroi jetë në atë dunën e kuqe.

I Dërguari i Allahut salAllahu alejhi ue selem ka thënë në hadithin që e shënon Buhariu: *“Po të isha aty, do t’ua tregoja varrin e tij në skaj të rrugës te duna e kuqe.”*²

Beni Israilët vazhduan të endeshin dhe bredhin për dyzet vjet derisa i nxori Allahu me duart e djaloshit, që u takua me Musain alejhi selam në rrëfimin e përmendur me Hidrin. Ai është peygamberi i Allahut Jusha b. Nun alejhi selam. Ai i nxori dhe i çoi në Jordani. Nga këto ndodhi të njëpasnjëshme del si argument, se Musai alejhi selam ka qenë mjaft i kujdesshëm për Beni Israilët, të cilët e kishin bërë shprehi kufrin, mposhtjen dhe inatin kundër të vërtetës.

Bredhja e jehudëve dhe humbja e tyre në tokë dyzet vjet ka ndodhur për ta shkatërruar atë gjeneratë jobesimtarësh dhe inatçish të jehudive, e pastaj pas tyre të vijë një gjeneratë e re, që janë edukuar në duart e peygamberëve alejhi selam.

Jehudët pas Musaut alejhi selam - Viti 1186 p.e.s.

Jusha b. Nun

Në këtë vit i udhëhoqi Jusha b. Nuni alejhi selam Jehuditë në drejtim të tokës së shenjtë Makdisit. Ata shkuan në Palestinë e jo në Bejtul-Makdis, siç qëndron në transmetimet më të vërteta. Kanë gabuar ata që kanë thënë

“Jusha b. Nuni e luti Zotin e Lartmadhëruar që ta ndalë Diellin dhe Dielli u ndal në vend dhe nuk lëvizte derisa mbaroi beteja dhe ngadhënyen jehuditë ...”

se ata e kanë çliruar Bejtul-Makdisin. E vërteta është se ata kanë shkuar në Eriha. Aty ngjau beteja mes tyre dhe Amalikëve trima e të fortë, që janë përmendur në Kuran. Ata kanë qenë nga Kenanët. Beni Israilët e pushtuan Erihanë dhe banuan aty. Librat e historisë dhe të hadithit e kanë theksuar këtë betejë dhe po ashtu Kurani Famëlartë në thënien e Allahut : *“E kur ju thamë: ‘Hyni në këtë fshat (vendbanim), dhe hani në të lirisht ku të dëshironi, e hyni në derën (e fshatit) të përulur dhe thuani: ‘Hittatun’ - ndjesë, Ne ua falim mëkatet tuaja, e bamirësve ua shtojmë shpërblimin.’”* Bekare 58.

Kjo betejë është zhvilluar në ditën e xhuma. Allahu ua kishte ndaluar punën dhe luftën në ditën e shtunë. Dielli po i afrohej perëndimit dhe ata u frikësuan se mos po i takon dita e shtunë me luftë pa e fituar betejën. Atëherë, Jusha b. Nuni e luti Zotin e Lartmadhëruar që ta ndalë Diellin dhe Dielli u ndal në vend dhe nuk lëvizte derisa mbaroi beteja dhe ngadhënyen jehuditë. Kjo është e verifikuar edhe me sunetin e vërtetë (sahih). Hafidh b. Haxheri ka thënë: është transmetuar nga rrugë të vërteta, që i ka nxjerrë Imam Ahmed i ruga e Hishamit,

¹ DUNË f. sh. gjeo. Kodër a stom rëre, që formohet nga era në shkretëtira ose brigjeve të detit dhe që me kohë mund të zhvendoset dalëngadalë nga një vend në një tjetër prej erës.

² Sahihul Buhari nr. 3407

nga Ibën Sirini, nga Ebu Hurejre që ka thënë se Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem, ka thënë: ***“Dielli nuk është ndalur për asnjërin, përpos për Jusha b. Nunin në netët që marshoi në drejtim të Bejtul-Makdisit”***. Kështu pra, ata e panë edhe një mrekulli tjetër madhështore para syve të vet.

Hyrja në fshat

Pastaj pejgamberi i tyre i urdhëroi që të hynë në fshat e të hanë çfarë të duan, me kusht që të hyjnë tek porta të përulur dhe të thonë “Hittatun” (ndjesë) që do të thotë: O Zoti ynë, na i fal neve mëkatet. Mirëpo ata thanë “Hintatun” padrejtësisht me mendjemadhësi dhe kryeneçësi ndaj urdhrave të Allahut të Lartmadhëruar. Ata u tallën me Jusha b. Nunin alejhi selam. I thoshin ne ngadhënjem vetëm me forcën tonë. Kur i urdhëroi të hynë në fshat të përulur, ata ktheheshin dhe hynë me prapanicë. Pra, analizoje këtë popull inatçi dhe jobesimtarë!!

Allahu i Madhëruar në lidhje me çastin kur i ka urdhëruar të thonë “hittatun” e ata e ndruan në “hintatun” ka thënë: ***“E ata që ishin mizorë atë që u ishte thënë e ndryshuan me një fjalë tjetër, e Ne për shkak se ata kundërshtuan, lëshuam nga qielli një dënim kundër atyre që ishin mizorë.”*** Bekare 59.

Devijimi i Beni Israilëve

Jehudët qëndruan në Palestinë dhe kryeqytet e bënë Urejhën (Erihanë) derisa vdiq Jusha b. Nuni, alejhi selam. Pastaj ata u ndanë dhe u përçanë. Ata patën edhe luftime mes tyre. Allahu i Lartmadhëruar u dërgoi pejgamber, siç ka thënë profeti ynë fisnik: ***“Çdo herë që vdiste ndonjë pejgamber, e***

zëvendësonte një pejgamber tjetër”.³ Shumë pejgamber pati te ky popull, saqë përnjëherë ka pasur edhe nga tre pejgamberë në një vend. Allahu i Madhëruar ka thënë: ***“Përmendju atyre një shembull të banorëve të fshatit, kur atyre u patën ardhur të dërguarit. Kur Ne dërguam tek ata dy, e ata i përgënjeshtroan që të dy, atëherë i përforcuam me një të tretë dhe u thanë: “Ne jemi të dërguar te ju.”*** Jasin 13, 14.

Ata nuk i respektonin pejgamberët, por më vonë filluan edhe t'i mbysin ata. Allahu i përmend në Kuran me këto vepra të shëmtuara: ***“Dhe për shkak të thyerjes së besës së dhënë, të mohimit të ajeteve (shpalljes) të Allahut, të mbytjes së pejgamberëve pa kurrfarë të drejte dhe thënies së tyre: “Zemrat tona janë të mbuluara” (me perde). Jo, por për shkak të mohimit të tyre Allahu ua vulosi ato (zemrat), e nuk besojnë prej tyre vetëm pakkush.”*** Nisa 155

Kështu mosbesimi u ngulit në zemrat dhe shpirtrat e tyre. I bënë shprehi shirkun dhe mëkatet. Allahu i Madhëruar në lidhje me këtë ka thënë: ***“(Përkujtoni) Kur morëm premtimin tuaj dhe mbi ju ngritëm kodrën Tur, (u thamë) merrni këtë që u dhamë seriozisht dhe dëgjoni (respektoni). Ata thanë: “Dëgjuam (me veshë) e kundërshtuam”. E për shkak të mosbesimit të tyre, adhurimi ndaj viçit ishte përzier me gjak në zemrat e tyre. Thuaj: “Nëse jeni besimtarë, besimi juaj është duke u udhëzuar keq.”*** Bekare 93. Ata vazhduan të bëjnë mëkate e të mbajnë inat, të mbysin pejgamberët e gjynahe të tjera. Me këto veprime tek ata nuk ka mbetur më asnjë njeri me vlerë, meqë ata edhe pejgamberët i mbytnin, duke qenë ata nga mesi dhe origjina e tyre. Allahu u zemërua me ta dhe i ndëshkoi. Allahu i Madhëruar ka thënë: ***“...E mbi ta rëndoi poshtërimi dhe skamja, e ata kundër vetes shkaktuan***

3 Sahihul Buhari nr. 3455

hidhërimin e Allahut. Kjo ndodhi ngase ata mohonin argumentet e Allahut, mbytnin pejgamberët pa kurrfarë të drejte, dhe për shkak se kundërshtuan dhe i kalonin kufijtë në të keqe.” Bekare 61.

Persekutimi i Beni Israilëve

Në këtë gjendje Beni Israilët u mbizotëruan nga Amalikët (kenanitët) dhe iu dhanë dënime të ndryshme, duke i nënçmuar dhe duke i lënë në skamje. Ua morën Beni Israilëve gjërat e shenjta dhe pasurinë. Në mesin e këtyre gjërave të shenjta ua morën edhe Arkën. Kjo Arkë për Beni Israilët ishte gjëja më e shtrenjtë. Ai ishte një sënduk, ku ata ruanin pllakat, që i kishte shkruar Allahu, Musait alejhi selam. Allahu i Madhëruar ka thënë: *“Dhe i përshkruam atij në pllaka çdo gjë (që i nevojitej), si këshillim dhe sqarim për secilin send. “Merri këto me seriozitet dhe urdhëroje popullin tënd që t’i përvetësojë më të mirat e tyre (dispozitat me shpërblim më të madh). Unë do t’ua tregoj vendbanimin mëkatarëve.”* Araf 145

Këto pllaka Beni Israilët (para se t’ua marrin ato) i kishin ndryshuar gjatë jetës së tyre. Thuhet se kanë mbetur vetëm dy nga dhjetë origjinalet në arkë. Aty po ashtu ka qenë edhe shkopi i Musait alejhi selam, teshat e tij dhe të vëllait të tij Harunit alejhi selam. Allahu i Madhëruar ka thënë: *“Pejgamberi i tyre u tha: “Shenjë e sundimit të tij është që t’ju sjellë arkën, që e bartin engjëjt dhe që në të gjeni qetësim (shpirtëror) nga Zoti juaj, e edhe diçka që ka mbetur nga thesari i familjes së Musait dhe Harunit. S’ka dyshim se ky, po qe se jeni besimtarë, është një fakt për ju.”* Bekare 248

Taluti mbreti i ri

Në këtë gjendje mbetën derisa erdhi mbreti i kenanitëve Xhaluti, i cili qeverisi në

Bejtul-Makdis, ndërsa Beni Israilët ishin të dështuar, të nënçmuar e të shkapërderdhur andej-këndej pa kryetar që t’i bashkojë dhe t’i nxjerr nga kjo gjendje shumë e keqe. Atëbotë i kishin thënë pejgamberit të tyre: na i kthe neve krenarinë dhe famën dhe laroje nga ne poshtërimin. Na jep neve një mbret, që të ecim pas tij dhe ta realizojmë fitoren tonë. Pejgamberi i tyre u tha: Ju keni një të kaluar dhe histori të zezë. A thua vallë ju, nëse Allahu u çon ndonjë mbret do ta respektoni atë, do t’i përuleni dhe nuk do t’ia kundërshtoni urdhrin? Ata thanë: Pse mos ta respektojmë kur ne sot jemi më të poshtëruarit. Si ta kundërshtojmë urdhrin e tij, kur ai dëshiron të na rikthejë krenarinë dhe famën për popullin tonë?!

Pejgamberi i tyre i lajmëroi, se Allahu ua ka zgjedhur mbretin dhe ai është Taluti. *“Pejgamberi i tyre u tha: “Allahu caktoi sundues tuajin Talutin”.* Bekare 247

Mirëpo ata thanë: Nuk na pëlqen që ky të na bëhet mbret, sepse Taluti nuk është me origjinë nga paraardhësit tanë jehudi te të cilët kanë qenë mbretërit. Po ashtu me inat kanë thënë: *“Si mund të jetë ai sundues yni, kur ne kemi më shumë meritë se ai për sundim, madje ai edhe nuk është i pasur”?* Ai tha: *“Allahu e zgjodhi atë sundues tuajin dhe e pajisi me dituri të gjerë e me fuqi trupore”!* Allahu ia jep sundimin e vet atij që do, Allahu është dhurues i madh, i dijshtëm.” Bekare 247

Me gjithë atë që i pati goditur jehuditë nga poshtërimi dhe dobësia, ata nuk e ndryshuan natyrën e tyre ku e kishin të rrënjësuar me kufër, mosbesim e gjynahe. Ky ka qenë dhe është morali i tyre kurdoherë dhe të tillë kanë qenë në përgjithësi. ■

(Vazhdon)

Përktheu: Ali SHABANI